MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Delegacioni
i Komisionit Europian

JACOBS

LOUIS BERGER S.A.

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS

Komuna Velipojë

për një komunitet të shëndetshëm
në mjedis të shëndetshëm



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Komuna Velipojë

Përgatitur në kuadër të projektit CARDS "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri - ELPA" Financuar nga Komisioni i Delegacionit European, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Zbatuar nga Jacobs, Louis Berger S.A dhe Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri

Viti i botimit 2006
Shtypur pranë shtypshkronjës Gent Grafik, Tiranë

Ky dokument është përgatitur me ndihmesën e:

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

http://albania.rec.org

Në bashkëpunim të ngushtë me:
Komunën Velipojë, drejtoritë dhe inspektoriatet që veprojnë në komunë, ekpertë rajonalë dhe të projektit ELPA

dhe me kontributin e:

Agim Hoxhaj, Alken Myftiu, Daniela Tola, Drita Kruja, Eduart Cani, Fatbardh Sokoli, Filip Kërcunga, Gege Pergjeçaj, Gjovalin Bregna, Marash Keci, Mihallaq Qirjo, Rikard Malaj

Përmbajtja

A-B. Parathënie 7
C. Analiza e përgjithshme e mundësive dhe pengesave në zhvillimin e komunës Velipojë 9
1. Analiza e gjendjes 11
1.1 Karakteristika të përgjithshme (Pozicioni, zhvillimi hapsinor, klima)
1.2 Zhvillimi i sektorit bujqësor
1.3 Larmia biologjike dhe zonat e mbrojtura
1.4 Zhvillimi i Turizmit, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit

2. Lista e problemeve 31

3. Vlerësimi i mundësive – Rekomandimet 43

4. Plani i Veprimeve 51

5. Monitorimi dhe Vlerësimi 63

Shkurtime

ELPA ----------Projekti "Legjkislacioni dhe Planfikimi Mjedisor në Shqipëri
REC ----------Qendra Rajonale e Mjedisit
SKM ----------Strategjia Kombëtare e Mjedisit
PRVM ----------Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis
MMPAU ----------Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave
KRRTSH ----------Këshilli i Rrergullimit të Territorit të Shqipërisë
DSHP ----------Drejtoria e Shërbimit Pyjor
MPÇS ----------Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
MPPTT ----------Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
KQ ----------Këshilli i Qarkut
NBO ----------Nevoja Biologjike për Oksigjen
IUCN ----------Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
OJF ----------Organizata Jofitimprurëse
ARM ----------Agjencia Rajonale e Mjedisit

A. Parathënie

Ky dokument është përgatitur ne kuadër të projekti CARDS "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri (komponenti i planfikimit mjedisor)". Qëllimi kryesor i ELPA është të mbështesë objektivat e Qeverisë shqiptare në përmbushjen e principeve të zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me bisedimet për futjen në BE. Kjo përfshin forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të qeverisjes vendore dhe ngritjen e kapaciteteve në proceset e hartimit të Planeve Mjedisore në nivel rajonal dhe vendor.

PLVM është i lidhur ngushtësisht me komponentët e tjerë te projektit ELPA:

- Strategjia Kombetare e Mjedisit përcakton politikat për të gjithë sektorët e zhvillimit duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore të përdorura për zhvillim si dhe mbrojtjen e larmisë biologjike.
- Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis pë deltën e lumit Drin (Shkodër - Lezhë);
- Planin pilot të bregut nga derdhja e lumit Ishëm deri në derdhjen e lumit Buna;
- Ngritjen e ndërgjegjes mjedisore në nivelet rajonale dhe vendore. Procesi i konsultimeve publike të ndërmarra në kuadër të PLVM është në një linjë me legjislacionin e BE për planet e zhvillimit.

Lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet secilit nga dokumentat e sipërpërmendura jepet në kapitullin 4 (Plani i Veprimit) të këtij dokumenti.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në linjë me përpjekjet e qeverisë shqiptare për forcimin e mëtejshëm të proceseve të planifikimit mjedisor në të gjitha nivelet ashtu si kërkohet dhe nga Procesi i Asocim-Stabilizimit dhe Brenda projektit ELPA, si një ndihmesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Mjedisit.

Qëllimi i këtij dokumenti është të adresojë the zhvillimin e paplanifikuar, zhvillimin e shpejtë të nismës private e shoqëruar me ndërhyrje të pakontrolluara në infrastrukturën ekzistuese, e cila ka ndikuar negativisht në natyrë dhe në shëndetin e popullatës. Në shtesë të kësaj, krijimi i qendrave të reja të banuara, ka rritur presionin mbi infrastrukturën e pazhvilluar të zonës. Zbritja e popullsisë nga zonat malore ka gjendur të paërgatitur autoritetet vendore dhe ka cuar në zhvillime kaotike në të gjithë zonën, si dhe rritje të problemeve të turizmit në zonën bregdetare.

Duke marrë në konsideratë mungesën e sistemeve të kontrollit dhe ndërgjegjësimin e ulët të fushës së biznesit, insitucioneve dhe komunitetit për çështjet e mjedisit, projekti ka punuar në përfshirjen e mjedisit në axhendën e përditëshme të autoriteteve vendore dhe ka forcuar mënyrat dhe metodat e komunikimit me publikun në dobi të pjesmarrjes dhe vendimmarrjes për cështjet mjedisore

Grumbullimi i të dhënave të disiplinave të ndryshme në komunë, duke filluar nga veçoritë fiziko - gjeografike, trualli, pasuritë natyrore dhe nëntokësore, uji, bujqësia, biodiversiteti, pyjet, peshkimi, hidro - gjeologjia të dhëna demografike, përdorimi i terreneve, energjia, mbetjet urbane, edukimi etj., pasi kaluan në disa stade diskutimi dhe përmirësimi, janë konceptuar në një dokument të integruar me një fokus të qartë të mbrojtjes së natyrës.

Dokumenti sjell një analizë të të dhënave të 50 viteve të fundit në disiplina të ndryshme sipas kushteve të ndryshme të relievit të kësaj zone (rrafshina detare, liqenore, ultësira

pranë - adriatike, lugina e kanione të ndryshme, laguna, etj). Plani Lokal Mjedisor i zonës që mbulon të gjithë komunën Velipojë, ishte një ndërmarrje e vështirë, por me interes të madh. I zbërthyer në kapitujt bazë të analizës së gjendjes, rekomandimeve dhe planit të veprimeve, ai sjell një vizion të ri zhvillimit ndërdisplinor në Shqipëri, fushat e ndryshme me ndikim të ndërsjelltë, janë sjellë në mënyrë të harmonizuar dhe në respekt të natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Dokumenti pritet ti shërbejë autoriteteve qendrore dhe vendore, biznesit, organizatave të ndryshme, specialistëve dhe grupeve të tjera të interesuara, për të zhvilluar më tej vizionet e tij për një zhvillim me bazë përdorimin e pasurive natyrore në mënyrë të qëndrueshme në komunën e Velipojës.

B. Procesi dhe metodologjia

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për komunën Velipojë, është hartuar nga specialistë vendorë të kësaj komune, ekspertëve kombëtarë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, si dhe me ndihmën e ekspertëve të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) dhe atyre ndërkombëtarë nga projekti ELPA.
I zhvilluar në tre pjesë kryesore, PLVM është konceptuar në kapitujt kryesorë: Analiza e situatës, Rekomandime dhe strategjia për zhvillim, dhe Plani i Veprimit. Duke u kujdesur në mënyrë të vecantë në ndërveprimet ndërmjet çështjeve të ndryshme, për secilën çështje paraqitet problematika, rekomandimet dhe ndërhyrjet konkrete. Kështu, dokumenti trajtohet në një rrjedhjë logjike, ku së pari përcaktohet dhe analizohet problemi, dhe më pas jepen rrugët e mundëshme të zgjidhjes.
Një nga hallkat më të rëndësishme të procesit ka qenë diskutimi i gjetjeve dhe përfundimeve të dokumentit me një numër të konsiderueshëm specialistësh vendorë dhe përfaqësues të komunitetit në të dy rajonet. Me qëllimin e përgatitjes së një dokumenti gjithëpërfshirës, janë ndërmarrë një sërë veprimtarish për konsultimin publik, nëpërmjet takimeve publike, tavolinave të diskutimit dhe thirrjes për bashkëpunim.
Ekipi i projektit ELPA dhe REC Shqipëri dëshirojnë të falenderojnë aktorët lokalë dhe rajonalë të përfshirë në këtë proces për mbështetjen dhe angazhimin e tyre në hartimin e PLVM, si modeli dhe prototipi i parë në Shqipëri.

C. Analiza e përgjithshme e mundësive dhe pengesave në zhvillimin e komunës Velipojë

Ky ushtrim është zhvilluar me grupet e punës të ngritura pranë Komunës Velipojë, bazuar dhe në analizën e nxjerrë nga "workshopi për zhvillimin rajonal (Shkodër Tetor 2005, Inwent - GTZ), me qëllim nxjerrjen në pah të elementëve që i japin mundësi kësaj zone me pasuri të mëdha natyrore që të zhvillohet më tej dret parametrave të një rritje të qëndrueshme, si dhe të marrë nën mbikëqyrje, me qëllim menaxhimin e tyre, rreziqet dhe pengesat që e ngadalsojnë zhvillimin.
Ky ushtrim tenton të jetë gjithmonë i diskutueshëm dhe në nevojë për ribërje në mënyrë periodike, duke i dhënë mundësi vendimmarrësve dhe sipërmarrësve që të gjejnë veten në përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre në të mirë të zhvillimit.

Pikat e forta	**Pikat e dobëta**
Shumëllojshmëria e habitateve natyrore, deti, lumi, laguna, pylli, mali Rëra shumë e mirë Burimet të pasura natyrore Afërsia me Shkodrën Bregdeti ende i pandotur Sipërfaqe e konsiderueshme plazhi Pozita gjeografike Vija bregdetare Toka pjellore Potenciale prodhuese bujqësi, blektori Ajri i pastër Klima e mirë Burime njerëzore Afërsia me tregjet potenciale Afërsia me Malin e zi Energji (elektrike) dhe ujë Prodhime tradicionale, bostan dhe patate	Menaxhimi i dobët i mbetjeve dhe cilësia e ulët e pastrimit Arritjet e pakëta të bujqësisë (Mos)menaxhimi i ujrave të zeza Investimet pa kriter Problemet e pronësisë mbi tokën Infrastruktura e dobët rrugore Pasivitet për ndërhyrje Mungesa e promovimit të vlerave Ndërtimet kaotike Mungesa e planit dhe e vizionit për zhvillimin e turizmin Komunikim i dobët me qeverinë lokale Mungesa e autoritetit të pushtetit lokal kulturë e ulët shërbimi Mungesa e kapaciteteve profesionale për rregullimin e territorit
Mundësitë	**Kërcënime**
Zhvillimi i bujqësisë Zhvillimi i turizmit Tendenca për mbështetje nga OJFtë Grumbullimit të bimëve mjekësore Rritja e prodhimeve bujqësore Zonë e përshtatshme për projekte zhvillimi Zhvillimi i peshkimit Zhvillimi i gjuetisë Aftësitë akomoduese Zhvillimi i sporteve të ndryshme Vullneti për zhvillim Interesi i të huajve Mundësi për përdorimin e energjive alternative (era dhe dielli)	Emigrimi i lartë Mangësitë ligjore lidhur me ligjin për tokën bujqësore Sëmundjet virusale Mungesa e ujit të pijshëm Ndotjet e mjedisit Moszbatimi i ligjeve Mosfunksionimi i pushtetit lokal Korrupsioni i lartë Konkurenca me vendet fqinje Pronësia mbi ndërtimet

1. Analiza e gjendjes

1.1 Karakteristika të përgjithshme (Pozicioni, zhvillimi hapsinor, klima)

Komuna Velipojë bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, gjendet në Jug-Perëndim të Qytetit të Shkodrës në një largësi prej rreth 24 km prej tij, në Veri-Perëndim kufizohet nga Mali i Zi përgjatë lumit Buna, në Lindje nga Qarku i Lezhës, në Veri nga Komuna e Dajçit dhe në Jug nga deti Adriatik. Sipërfaqja totale e Komunës është 72.4 km^2. E gjithë zona është një fushë e madhe e rrethuar nga kodrat e Baksit, Çasit, Shtiqnit dhe Maja e Zezë. Komuna ka një shtrirje të gjërë përgjatë bregut të detit Adriatik dhe me një plazh me moshë natyrore rreth 300 vjeçare.
Numri i popullsisë aktuale në tërë Komunën e Velipojës është 8270 banorë, një popullsi me tendencë rritjeje të shpejtë nga faktorë të ndryshëm si migrimi brenda territorit, tërheqja e vëmendjes së publikut për të investuar në turizëm etj. Komuna përbëhet nga 10 fshatra të cilët janë: Velipojë, Reç-Pulaj, Luarzë, Gomsiqe e Re, Baks-Rrjoll, Pulaj-Plazh, Reç i Ri, Baks i Ri, Ças, Mali Kolaj.

Velipoja karakterizohet nga klimë mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë, dimri është i lagësht dhe i butë. Era e murrlanit, karakteristike për Velipojën, e bën dimrin të acartë, ndërsa ne verë, era e Shirokut sjell lagështi.

1.1.1 Prania apo mungesa e planeve rregulluese
Ndryshimin më të madh dhe të shpejtë e ka pësuar plazhi i Velipojës, i cili para viteve 1990 kishte vetëm disa kabina dhe 3 hotele. Në fillim të viteve 1990 ka filluar një fluks ndërtimesh (konstruksione të lehta) për qëllime tregtare. Më përjashtim të disa rasteve në fshatin Pulaj, nuk ka pasur kthim pronash për ish-pronarët rreth territorit të plazhit. Në vitin 1995 është miratuar një master plan i hartuar nga një studio italiane që parashikonte plazhin e Velipojës – një plazh të turizmit cilësor, me hapësira për fshatra turistikë dhe arkitekturë në përputhje me mjedisin. Pas vitit 1997 kanë filluar ndërtimet masive në territorin e plazhit (pa leje ndërtimi) duke lidhur marrëveshje (ose blerë) nga ish-pronarët apo pretendentë të pronësisë mbi tokën (me përjashtim të tokave bujqësore të përfituara me ligjin 7501 dt. 19.07.1991 "për tokën" nuk kanë dokumentacion pronësie të viteve të fundit).

Për komunën Velipojë janë hatuar disa plane rregulluese dhe funksionale, të cilët nuk kanë gjetur rrugën e zbatimit të tyre, për shkak të mungesës së vizionit të plotë këtyre planeve dhe mungesës së autoriteteve për ti zbatuar ato. Kështu përmendim:

a. Studim urbanistik dhe shesh ndërtimi për fshat turistik në Velipojë me sip 8.5 ha, miratuar nga KRRTRSH, vendim nr 8 dt 16.09.2000;
b. Studim urbanistik për zhvillimin turistik e mbrojtjen e zonës turistike Velipojë, miratuar me Vendim Nr.1 dt. 18.06.2003 nga KRRTRSH-ja;
c. Nga Instituti i Studimeve e Projektimit, është përgatitur një plan tjetër urbanistik, i cili merr në konsideratë ndërtimet e bëra, por që është i pamiratuar nga KRRTRSH-ja.

Nga projekti ELPA është përgatitur plani funksional në mbrojtje të pasurive natyrore dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm[1]. Ky plan mbetet plani më i kompletuar hapsinor, i cili i jep Velipojës mundësi zhvillimi dhe përparimi në harmoni me të gjithë elementët e jetës në këtë komunë. Megjithatë, ky plan kërkon studime të tjera pjesore,

1 Projekti "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri", përfunduar me 2006, ka hartuar një zonim funksional të zonës bregdetare nga derdhja e lumit Ishëm në Jug deri në derdhjen e lumit Buna në Veri.

për mënyrën e menaxhimit brenda zonave të vecanta të përcaktuar prej tij dhe nga vendimi i MMPAU për shpalljen e të gjithë komunës, në kategori të ndryshme të zonave të mbrojtura.
Me gjithë këto studime, si rezultat i mungesës së fondeve nuk janë realizuar disa nga projektet më të rëndësishme për zhvillimin e saj, ku përmendim:

a. Studime në fushën e planifikimit e zhvillimit territorial;
b. Plani i përgjithshëm rregullues dhe studime urbanistike pjesore;
c. Shqyrtimi e miratimi i lejeve të ndërtimit.

Sipas një llogaritje të bërë, në komunën Velipojë rezultojnë rreth 500 ndërtime pa leje, të përqendrura në zonën e plazhit si dhe gjatë rrugës së Vilunit. Këto janë ndërtime kaotike dhe jo në përshtatje arkitektonike. Ato janë nga 1 deri në 5 kate.

1.1.2 Ndryshimi i popullsisë dhe struktura demografike
Numri i popullsisë në Komunën Velipojë është 8270 banorë, ku 4073 femra dhe 4197 meshkuj, pra në raporte afërsisht të barabarta.
Komuna përbëhet nga 10 fshatra (në grafikun 1 paraqitet numri i popullsisë për secilin fshat sipas gjinisë), ku numri më i madh i popullsisë është në fshatin Velipojë (si zonë e rëndësishme turistike)



Grafik 1 - numri i popullsise për secilin fshat sipas gjinisë

Popullsia është heterogjene e ardhur në kohë të ndryshme dhe nga zona të ndryshme të periferisë së Qarkut. Në këtë zonë bashkëjetojnë harmonishëm kulturat e zonës së Malësisë së mbi Shkodrës, të Zadrimës, Malësisë së Dukagjinit dhe asaj të Mirditës. Jeta e përbashkët ekonomike e sociale ka ndikuar në përzierjen e elementëve të kulturave të ndryshme. Megjithatë, në ceremonitë familjare e fetare, veshje, mënyrën e jetesës në familje, të folurin (nëndialektet), dallohen dukshëm elementët specifikë të secilës kulturë. Burimet njerëzore në zonën e Velipojës kanë potencialin e nevojshëm për tiu përgjigjur sfidave të zhvillimit: mbi 100 persona janë me arsim të lartë të profileve të ndryshëm, shumë banorë kanë arsimin e mesëm dhe të kualifikuar në profesione të ndryshme.
Aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë së Velipojës janë bujqësia, blegtoria dhe vitet e fundit ndërtimi, turizmi familjar dhe agroturizmi.

1.1.3 Migrimi në zonën e Velipojës
Numri i familjeve për Komunën Velipojë nga viti 2000 në 2005 është rritur me 69 familje, por pavarësisht nga kjo në disa fshatra ka rënie të numrit të tyre. Kjo ndodh si rezultat i emigracionit, migrimit në zonat urbane dhe vecanërisht në zonat bregdetare

të komunës. Kjo ndeshet tek fshatrat Velipojë, ku numri i familjeve është rritur me 210 familje dhe Pulaj me 99 familje.



Grafik 2. Ndryshimi i popullsisë sipas fshatrave në vitin 2000 dhe 2005

1.1.4 Punësimi dhe arsimimi

Në komunën Velipojë nuk gjejmë të dhëna të sakta në lidhje me punësimin dhe arsimin e banorëve. Sipas Komunës mbi 100 banorë kanë arsimin e lartë (mësues, veterinerë, agronomë, zooteknikë dhe shumë pak inxhinierë dhe ekonomistë). Ndërkohë që Komuna Velipojë duhet të drejtojë vëmendjen e të rinjve drejt këtyre degëve për arsimim.

Pjesa më e madhe janë të punësuar në sektorin privat si bujqësi, njësi tregtare dhe ndërtim etj., por të parregjistruar si punëkërkues aktivë në zyrat e punës.

Në komunën Velipojë përfitojnë ndihmë ekonomike 247 familje (12% e popullsisë), ku 172 trajtohen për paaftësi dhe 75 me ndihmë sociale.

1.1.5 Të ardhurat

Të ardhurat e komunës në vitin 2005 në krahasim me vitin 2004 shënojnë një rënie prej 281.000 lekësh, kryesisht prej punës jo të mjaftueshme të administratës së Komunës, e cila duhet të forcojë masat shtrënguese dhe të ndërgjegjësojë biznesin dhe komunitetin në pagimin e detyrimeve ndaj pushtetit vendor.



Grafik 3. Të ardhurat e komunës nga taksat dhe tarfiat

1.1.6 Zhvillimi i bizneseve

Në komunën Velipojë veprojnë 63 biznese të vogla dhe 6 biznese të mëdha.

Lloji biznesit	Nr.bizneseve
Prodhime inerte	4
Materiale ndërtimi	3
Tregti me pakicë	21
Karburant	4
Punime duralumini	2
Baxho	3
Bilardo	1
Tregti gazi	1
Bar-bufe	10
Furrë buke	1
Oficinë	2
Farmaci	1
Firmë ndërtimi	1
Parukeri	1
Punime druri	1
Fushe minifutboll	1
Byrektore	2
Bar-restorant	10
Total 2005	69

Tabela 1. Llojet e bizneseve në komunën Velipojë

Sipas evidentimit të Komunës Velipojë për degën e tatimeve në fshatin Velipojë gjenden 95 hotele, të cila veprojnë si biznese më vete dhe burim i mirë fitimi për pronarët e tyre. Ata janë të palicensuar ndaj nga komuna është kërkuar licensim provizor nga dega e tatim-taksave. Numri i dhomave të tyre arrin nga 6 në 30.

1.1.8 Shërbimet

a. Rrugët

Rruga kombëtare, pas një kthese 90^0, hyn në Plazhin e Velipojës. Sipas konceptit të mëparshëm të një plazhi pak të frekuentuar, me numër të kufizuar ndërtimesh, para pallateve, ka një lulishte dhe një shesh i cili ende ka mbetur i pa zënë në gjerësi 30 ml dhe gjatësi 800 ml dhe që sot funksionon si shëtitore. Gjithashtu, ekziston rruga që vazhdon nga qendra e plazhit për tek hidrovori i Vilunit, që të nxjerr në breg të kënetës së Vilunit për të shkuar në fshatin Rrjoll, përmes një ure vetëm për këmbësorë . Ndërtimet e pakontrolluara dhe mungesa e zbatimit të planit të zhvillimit të plazhit, kanë bërë që rrugët hyrëse për në plazh si dhe rrugët e brëndshme që lidhin qendrën e plazhit ose rrugën kombëtare me hotelet, janë të vështira për tu përshkuar dhe mirëmbajtur. Ndaj mund të thuhet se mungon rrjeti rrugor i komunikimit në territorin e plazhit, rrugët e brendshme janë plotësisht të shkatëruara dhe në ditët me shi bëhen pothuajse të pakalueshme. Parkimi i mjeteve në territorin e plazhit, në kushtet e mungesës së vendeve të parkimit të përbashkët, shton kaosin në periudhën e verës. Rregullimi i fluksit të hyrjeve në plazh përmes vendosjes së tarifave të diferencuara të parkimit në ditë të veçanta të javës, duke stimuluar pushuesit të udhëtojnë me autobus do të shërbente hyrjes së një numri më të kufizuar mjetesh e për pasojë një mjedis më pak të ndotur. Plani i zhvillimit do ti hapë rrugë si ndërtimit të një rrjeti funksional të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve dhe mirëmbajtjes së tij në të ardhmen, si qendër urbane, e cila në periudhën 3 deri 4 mujore thith një popullsi rreth 40 – 50 mijë banorë.

Mesatarisht në Velipojë në periudhën e verës hyjnë 1900 -2100 mjete vetura, furgona që transportojnë pasagjerë drejt bregut të detit, në ditët e shtuna e të diela ky numër arrin deri në 4500-4700 mjete, qarkullimi dhe parkimi i të cilave kërkon sistem rrugor dhe sheshe parkimi të mirëorganizuara.

b. Hapësirat e gjelbërta

Në pjesën jashtë rezervatit natyror të Velipojës, është dëmtuar dhe vazhdon të degradohet brezi i gjelbër me pisha që fillon prej "vilës qeveritare" deri në breg të lagunës së Vilunit. Ndërtimet e pakontrolluara dhe copëzimi i sipërfaqeve të territorit bën që të ngushtohen vazhdimisht hapësirat e gjelbërta dhe ato për çlodhje dhe argëtim të pushuesve. Në kushtet e mungesës së një studimi, këto hapësira po kthehen në troje ndërtimi duke prerë pishat ose duke u shndëruar në vënde të depozitimit të mbetjeve.

c. Uji i pijshëm

Furnizimi me ujë për Komunën Velipojë bëhet nga fshati Trush, nga një largësi prej 12 km. Rrjeti i ujësjellësit është me sistem pompash me ngritje mekanike, sistem depozitimi dhe sistem me rrjedhje të lirë. Stacioni ujësjellësit Trush ka 4 pompa vertikale dhe 1 horizontale. Komuna ka dy sisteme ujësjellësi, njëri furnizon fshatin Mali Kolaj dhe tjetri fshatrat e tjera të komunës.

Situata e furnizimit me ujë është përmirësuar, pasi në disa fshatra ka përfunduar faza e dytë e ujësjellësit. Duhet të theksojmë që cilësia e ujit nuk është në nivelin e dëshiruar, pasi rrjeti është shumë i amortizuar.

Në tabelat e mëposhtme jepen skema dhe të dhëna të furnizimit me ujë të pijshëm.

Fshati	Rrjet sistemi me ngritje mekanike	Rrjet sistemi me rrjedhje të lirë	Nr. Stactioneve të ujësjellsave	Nr. i sistem. pompimit
Pulaj -Plazh	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Velipojë	+	Nuk ka	1	4 vertikale
Rec pulaj	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Luarz	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Gomsiqe e re	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Baks Rrjoll	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Mali Kolaj	+	Nuk ka	1	1 horizontale
Baks i Ri	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Rec i Ri	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Cas	+	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Tabela 2. Skema e furnizimit me ujë të pijshëm Komuna Velipojë

Fshati	Prodhimi i ujit (m3/vit	Kapac maksimal i prodh(l/s)	Gjat. Rrjet. Shpernd (km)	Gjatësia rrjetit të jashtëm (km)	Kapac. Depozit. (m3)	Përfitues (familje)
Velipojë	439200	20	23	16	800	1300
Mali Kolaj	58560	5	6	4	100	70

Tabela 3. Të dhëna për furnizimin me ujë të Komunës (të dhënat janë vetëm për fshatrat, të cilët kanë stacione të ujit të pijshëm)

d. Sistemet e ujrave të zeza

Në komunën Velipojë nuk ka kanalizime të ujrave të zeza. Në të gjithë komunën përdoren gropat septike, sipas modeldit më të keq të tyre dhe numri i tyre është pothuajse i barabartë me numrin e shtëpive. Çdo familje grumbullon ujrat e zeza në gropa septike individuale. Familjet që banojnë në pallate, (Ças: 12 pallate, Reç i Ri: 13 pallate dhe Velipojë 1 pallat) kanë sisteme me gropa septike të përqëndruara. Në këto mjedise ujrat e zeza shpërthejnë dhe dalin përgjatë rrugës, duke paraqitur rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektuese. Kjo "zgjidhje" është jashtë të gjithë standarteve dhe përbën rrezik edhe për ujrat nëntokësorë dhe zonën e plazhit. Për zgjidhjen e problemit të ujrave të zeza, duhet mbajtur parasysh specifikat e fshatrave të Komunës. Vlen të theksohet se në pjesën më të madhe fshatrave, relievi dhe dendësia e vogël të popullsisë), lejon që problemi i ujrave të zeza të zgjidhet nëpërmjet laginateve (sistemit tre-gropësh me filtrim). Përpunimi i ujrave të zeza përbën nevojë të ngutshme për zonën e plazhit dhe për 5 nga fshatat e komunës. Problem paraqesin Fshati Pulaj-Plazh, Velipojë dhe në kuadër të zhvillimit të turizmit edhe fshati Baks-Rrjoll. Për ta, duhen projektuar sistemet e kanalizimeve me stacione pompimi dhe impiant të përpunimit të ujrave të zeza, meqë këto zona janë shpallur zona me prioritet zhvillimin e turizmit, kanë dendësi të madhe dhe fluks të madh ndërtimesh. Për fshatin Baks-Rrjoll këto dy të fundit nuk janë akoma problematike, por është e dukshme tendenca për zhvillim turistik të shpejtë. Gjithashtu në sistemin e kanalizimeve dhe të përpunimit të ujrave të zeza duhet të përfshihet edhe fshati Gomsiqe e Re, i cili ka përqendrim të ndërtimeve dhe dendësi mjaft të lartë të popullsisë. Shumë e nevojshme paraqitet vendosja e disa blloqeve të banjove publike në territorin e plazhit.

e. Mbetjet urbane

Për vlerat e larta të bregdetit në Velipojë, në vitet e fundit ka pasur një fluks të madh vizitorësh që frekuentojnë këtë plazh. Nga të dhëna të përafërta plazhi i Velipojës frekuentohet nga mesatarisht 25.000 pushues ditor, nga të cilët 14.000-16.000 janë rezidentë. Kapaciteti maksimal akomodues për pushues rezidentë nga hotelet dhe turizmi familjar është rreth 25.000 pushues. Në ditët pik numri i pushuesve ditor së bashku me ata rezidentë e kalon shifrën e 70.000 pushuesve. Ky fluks i madh pushuesish, sjell me vete një konsum shumë të madh produktesh e si rrjedhojë edhe një volum shumë të madh mbetjesh urbane. Nëse llogariten mbetjet urbane sipas mesatares së frekuentuesve të plazhit të Velipojës, del se për 25.000 pushues të prodhojnë mesatarisht 1kg mbetje për pushues, totali i mbetjeve shkon në 25 ton mbetje në ditë. Për gjithë sezonin me 90 ditë sasia e prodhuar është rreth 2.250 ton mbetje urbane për sezon, pa llogaritur depozitimet e lokaleve që veprojnë në këtë zonë dhe banorët e zonës. Mbetjet urbane nga banorët e përhershëm të zonës llogaritet me 0.7kg/ditë X 8300 banor = 5,81 ton/ditë x 365 ditë = 2120, 65 ton/vit. Pra gjithsej mund të llogaritet që komuna grumbullon dhe transporton rreth 4370 ton mbetje në vit.

Problem është mungesa e planeve të përgjithshme të shpërndarjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve, mungesa e kazanëve dhe koshave si dhe e mjeteve të transportit. Duhet të merret parasysh si volumi i krijimit të mbetjeve, relievi dhe shpërndarja në distancë e vendbanimeve. Gjithashtu, Plazhi i Velipojës duhet të pastrohet para fillimit të sezonit turistik nga papastërtitë që nxjerr deti.

f. Energjia elektrike.

Furnizimi i Velipojës me energji elektrike bëhet përmes nënstacionit në hidrovorin e Çasit, i furnizuar me linjë 35.000 kilovolt. Në plazh ka një nënstacion dhe një numër të konsiderueshëm gabinash elektrike, të shpërndara pothuajse në cdo ndërtim privat. Rrjeti elektrik shpërndarës, sikundërse gjithë sistemi tjetër infrastrukturor ka nevojë për një projekt teknik, pjesë e masterplanit të zonës. Nuk ka ndriçim të regullt në shëtitore dhe mungon totalisht ndriçimi në bregun e detit. Ndricimi do ta shndërronte

bregun e detit në një shëtitore shumë të frekuentuar dhe do të rrisë kohën e pranisë së pushuesve buzë detit. Në territorin e plazhit, prej tre vjetësh në sezonin veror, ka 24 orë pa ndërprerje.

1.2 Zhvillimi i sektorit bujqësor

1.2.1 Përdorimi i tokës

Komuna Velipojë, ka sipërfaqe toke bujqësore prej 2.700 ha, e ndarë në 10 fshatra, e mbjellë me kultura bujqësore si më poshtë.
Grurë 250 ha e barabartë me 9 % të sipërfaqes.
Misër 100 ha e barabartë me 3.7 % të sipërfaqes
Perime dhe patate 50 ha e barabarte me 1.85 % të sipërfaqes
Frutikulturë dhe vitikulturë 55 ha e barabartë me 2 %
Foragjere 1000 ha e barabartë me 37 %
Tokë djerrë 1245 ha e barabartë me 46 % të sipërfaqes së tokës bujqësore.

1.2.2 Blektoria

Përqëndrimi më të madh i blektorisë është në fshatrat Ças, Reç i Ri, Mal Kolaj dhe Baks-Rrjoll. Në fshatrat Ças dhe Reç i Ri ka një mbarështrim më të madh të gjedhit, meqë në këto zona kultivohen më shumë foragjeret dhe kultura e misrit për blektorinë. Ndërsa për fshatrat Mali Kolaj dhe Baks-Rrjoll, mbarështohen më tepër të imtat, dele dhe dhi. Këto fshatra kanë traditë në mbarështrimin e dhisë (Mali Kolaj).

Fshati	Numuri fermerëve	Gjedhë	Të imta (dhen plus dhi)
Velipoja	330	400	660
Rec i ri	248	315	75
Baksi i Ri	123	170	85
Mali Kolaj	133	177	345
Baks - Rrjoll	91	115	295
Luarz	116	198	50
Pulaj - Plazh	158	150	0
Gomsiqe	233	258	40
Reç - Pulaj	84	119	70
Ças	148	185	170

Tabela 4. Shpërndarja e blegtorisë në raport me fermerët

Në territorin e komunës ushtrojnë aktivitet të përpunimit të qumështit katër baxho, të shpërndara në fshatrat Velipojë, Rec Pulaj, Ças, dhe Baks i Ri, që prodhojnë djathin si produkt kryesor dhe gjalpë, gjizë e hirrë si nënprodukte. Ato ushtrojnë aktivitetin e tyre gjatë gjithë vitit, por zotërojnë teknologji të vjetra dhe jo të përshtashme për higjenën dhe kërkesat e tregut.
Gjithashtu, ushtrojnë aktivitet si mikroferma të vogla më të imta, të cilët mbarështrojnë nga 300 deri në 1000 krerë të imta dele.

1.2.3 Prodhimtaria

Rendimenti prodhues për njësi sipërfaqe në komunën Velipojë, është i ulët, kjo për faktin se 30 % e sipërfaqes së tokës është mbi ujë dhe toka ka përbërje mekanike ranore, 12 % e sipërfaqes është tokë kodrinore e pavaditur dhe me strukturë të dobët.

Pjesa tjetër e sipërfaqes, janë toka me prodhimtari, por të paujitura, kjo si rezultat i shkatërrimit të sistemit ujitës pas 1990. Për rritjen e prodhimtarisë kërkohet: i) futja e sistemit vaditës; ii) mekanizimi i kulturave bujqësore; iii) përdorimim i plehrave organikë; iv) organizimi për krijimin e minifermave nga bashkimi i fermerëve.
Rritja e prodhimtarisë është një kërkesë e kohës, për faktin se numri i popullsisë është në rritje në mënyrë të vecantë, në periudhën e verës arrin nga 25 deri në 50 mijë banorë

Kultura	Sipërfaqja (ha)	Rendimenti (kv/ha)	Prodhimi (kv)
Grurë	250	25	6250
Misër	100	35	3500
Perime dhe patate	50	100	5000
Fruta +vitikulturë	55	75	4025
Foragjere	1000	120	120000

Tabela 5 Prodhimtaria sipas kulturave.

1.2.4 Punësimi në bujqësi
Aktualisht (viti 2006) në bujqësi punojnë retth 1.700 persona, por rendimenti i punës së tyre është i ulët për shkak të: i) mos bashkimit të fermerëve; ii) mekanizimit të ulët; iii) mungesës së fuqisë punëtore (të rinjtë janë në emigracion).
Duke qënë se rendimenti për ha është i ulët, për arsyet e lartpërmendura, përfitimet ekonomike, janë të ulëta, me përjashtim të disa produkteve sezonale, prodhime të tregtueshme në tregun e plazhit të Velipojës.

1.2.5 Sistemi drenazhues dhe kullues për qëllime bujqësore.
a. Sistemi i kullimit: Drenazhimi dhe kullimi, janë domosdoshmëri, për marrjen e rendimenteve të larta bujqësore. Drenazhimi, për kushtet specifike, të komunës Velipojë, nuk mund dhe nuk duhet të bëhet, për faktin se kemi toka ranore, torfike dhe kodrinore.
Përsa i përket kullimit, e gjithë sipërfaqja prej 2.700 ha, ka kryer kullimin që në periudhën e sistemit komunist. Ndërsa gjatë kohëve të fundit, është bërë vetëm pastrimi i kolektorëve dhe kanaleve të dyta. Ndërsa në kanalet e treta, nuk është bërë asnjë ndërhyrje. Ato janë mbushur dhe nuk pastrohen. Këto kanale nuk janë marrë përsipër nga shteti dhe vetë fermerët e kanë të pamundur të pastrojnë këto kanale për shkak të mundësive të pakta financiare dhe mungesës së ndërgjegjësimit të duhur për rëndësinë e tyre.
Kanalet kryesore kulluese (kolektorët) janë dy: njëri mbulon zonën Nr. 1 dhe ka gjatësi 4.1 km deri tek hidrovoti i Çasit; dhe kanali 2 (kolektori), mbulon zonën Nr 2 dhe ka gjatësi 12, 7 km dhe lidhet me hidrovorin Vilun.

Të dy kanalet së bashku, mbulojnë një sipërfaqe prej 4.000 ha që përfshijnë toka bujqësore dhe jobujqësore. Ndërkohë kanalet e dyta janë 9 (me një gjatësi prej 14. 2 km), kanalet kulluese të treta janë 103 (me gjatësi prej 7 km) të papastruar prej 20 vjetësh dhe në gjendje kritike për funksionimin e sistemit të domosdoshëm të kullimit.

Velipoja kërkon të bëhet një studim i ri specifik, meqë një pjesë e sipërfaqes së saj është torfike (në zonën e Çasit) dhe në 10-15 vitet e fundit, ka një rënie të nivelit të tokës.
Komuna Velipojë është pothuajse pak mbi nivelin e detit, e rrethuar me argjinaturë me

gjatësi 20.89 km, si më poshtë.
Argjinatura e Vilunit 6.9 km
Argjinatura Pentarit dhe Luarzit 6.8 km
Argjinatura Reç-Pulaj 7 km
Argjinatura e Çasit 1 km

b. Sistemi i ujitës: Sistemi i kanaleve ujitës përbëhet nga 4 kanale kryesore: kanali ujitës Murtemes-Pentar me gjatësi 9.5 km me fuqi 1.6 m3 ujë sekondë dhe me kapacitet ujitës për 650 ha tokë; kanali ujitës Ças me gjatësi 2.3 km, me fuqi 0.3 m3 ujë për sekondë dhe ujit 200 ha tokë; kanali ujitës Murtemes-Pulaj me gjatësi 14.5 km, me fuqi 2.2 m3 ujë për sekondë dhe ujit 1.000 ha tokë; kanali ujitës 10, parabolik, me fuqi 0.5 m3 ujë për sekondë, ujit 400 ha tokë.
Këto kanale janë ndërtuar vite më parë dhe kanë funksionuar shumë mirë, por aktualisht janë dëmtuar dhe funksionojnë pjesërisht.

1.3 Larmia biologjike dhe zonat e mbrojtura

1.31 Përshkrim i përgjithshëm
Biodiversiteti i zonës së Velipojës shquhet për larminë e llojeve dhe habitateve. Laguna e Vilunit si dhe Rezervati i Velipojës së bashku me kënetën e Domnit janë habitate të specifike për botën e gjallë. Laguna e Vilunit në Velipojë karakterizohet nga bimësi barishtore e ujërave të kripura. Këtu takohen një larmi jo vetëm bimësh barishtore, por edhe drunore. Gjatë viteve të fundit shfrytëzimi i skajshëm i pyjeve, i bimëve mjekësore, etj., ka sjellë pasoja negative për faunën e egër. Peshkimi i skajshëm dhe me mjete jo të përshtatshme ka çuar në pakësimin e burimeve peshkore. E gjitha kjo ka ndikimin e saj edhe në jetën e komunitetit dhe plotësimin e nevojave të tij duke shfrytëzuar burime të natyrës. Gjendja e biodiversitetit, sidomos në pesë vitet e fundit, paraqitet në përkeqësim. Kjo situatë ka ardhur për shkak të shfrytëzimit pa kriter të burimeve të natyrës, por edhe një numër i madh faktorësh të tjerë kërcënues ndër të cilët veçohen dëmtimi i habitateve si tharje e kënetave, prerja e pjesshme e pemëve, dëmtimi i kallamishteve, peshkimi me dinamit dhe lëndë helmuese. Përndjekja e kafshëve dhe gjuetia pa leje apo me mjete të jashtëligjshme, gjuetia jashtë sezonit si dhe dëmtimi i të vegjëlve apo vezëve të shpendëve janë faktorë kërcënues në këtë drejtim.
Një faktor me rëndësi që ka çuar dhe çon në humbjen e vlerave të biodiversitetit në zonën e Velipojës është edhe niveli i ulët i edukatës mjedisore të njerëzve si dhe ndërgjegjësimi i pakët i tyre.
Strukturat administrative për ruajtjen e vlerave natyrore në zonë janë gjithashtu të pakta dhe të pafuqishme për detyrën që ato kanë.
a. Bimët mjekësore
Bimët mjekësore që përdoren në komunën Velipojë janë; Sherbela, e cila gjendet me shumë në Mal Kolaj dhe Baks-Rrjoll, është bimë që nuk kultivohet, por ruhet dhe menaxhohet nga ish pronarët për të siguruar të ardhura. Nga një përllogaritje e përafërt, rezulton se në vit grumbullohen rreth 1.200 kv. Çmimi mesatar i shitjes është rreth 90 lek/ kg; Mullaga e bardhë, është bimë që gjendet me pakicë në këtë zonë, ruhet dhe menaxhohet më mirë nga përdoruesit.
Bimë të tjera mjekësore që njihen dhe përdoren, janë: Lule Blini; Kokra e Mrinës; Murrizi; Balsami; Kin fusha; Rënjë Rodhe; Barpresje; lule 100 fletësh; Gjuhë nuse, etj.

1.3.2 Zonat e mbrojtura
Zonat e mbrojtura të përfshira në rajonin e Velipojës, duke filluar që nga grykëdredhja e Bunës dhe deri në lagunën e Vilunit janë:

Lumi Buna dhe territoret ligatinore përreth tij, delta e Bunës, këneta e Domnit si dhe Laguna e Vilunit. Janë shpallur - Peisazh ujor, tokësor i mbrojtur. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

Ky peizazh ujor/tokësor i mbrojtur kufizohet:
Nga Veriu: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri në kufirin verior me Republikën Serbi-Mali i Zi (koordinatat 420 03'08" 190 29'30", 420 01'31" 190 29', 420 00'36'' 190 25'7", 420 00' 190 23'45");
Nga Perëndimi: Me vijën e kufirit shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Serbi-Mali i Zi;
Nga Lindja: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: 410 50'30" 190 35'30", 420 53'15" 190 30', 410 59'30" 190 31'30", 420 00' 190 31'33" , 420 02'15" 190 30', 420 03'08" 190 29').
Nga Jugu: Me vijën bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: 410 50'57" 190 23', 410 51'28" 190 27'30", 410 50'58" 190 30'.

Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur i lumit Buna ka një sipërfaqe të përgjithshme 23 027 ha, të përbërë nga:
a) sipërfaqe pyjore dhe shkurrore - 7 799 ha;
b) sipërfaqe lagunore - 346 ha;
c) duna ranore, bregdetare, - 496 ha;
ç) toka të kripura - 252 ha;
d) sipërfaqe të tjera (toka bujqësore, zona të banuara) - 14 134 ha.

Peizazhi ujor/tokësor i lumit Buna ka zonimin e mëposhtëm:
Zona qendrore : a) pjesa e lumit Buna dhe brigjet e tij nga bashkimi me lumin Drin deri në fshatin Obot; b) brigjet e lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervatit të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit deri përballë skajit verior të ishullit Ada dhe 200 m në brendësi të rezervatit në Lindje; c) ishulli i Franc Jozefit dhe bregdeti në Lindje të grykëderdhjes, në gjatësi deri 2 km dhe gjerësi 300 m në det, drejt Jugut; ç) pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit; d) gadishulli në plazhin e Baks-Rrjollit dhe një gjerësi 300 m në Jug të vijës bregdetare deri te Rëra e Hedhur; dh) pjesa qendrore e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

Zonë qendrore e përbërë nga: a) pjesa e lumit Buna në një gjatësi brigjesh 3 km në anën e djathtë të lumit, në Veri të fshatit Oblikë; b) pjesa e lumit nga fshati Obot deri në pikën përballë skajit verior të ishullit Ada me një gjerësi 200 m drejt Lindjes; c) gjithë sipërfaqja e rezervatit të Velipojës, ç) pjesa jugore e lagunës së Vilunit dhe gjithë sipërfaqja kënetore, që rrethon brigjet e lagunës; d) zona e Baks-Rrjollit deri në lartësinë 335 m në shpatin e malit Kolaj, në Veri; dh) pjesa e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës që e rrethon atë.
Në këtë zonë të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura".

Zonë qendrore e përbërë nga: a) pjesa e lumit Buna, me gjatësi brigjesh 2 km, midis fshatrave Shirq dhe Obot, në anën e djathtë të lumit; b) në gjatësi brigjesh 2 km të lumit Buna, në Veri të fshatit Dajç, në anën e majtë të lumit.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura"

Zonë e zhvillimit tradicional
Zonë e zhvillimit tradicional dhe e përbërë nga: a) fushat e Velipojës, me sipërfaqe 2 500 ha; b) fushat e Pentarit, me sipërfaqe 850 ha; c) pellgjet (ish-vaskat e peshkut) e fshatit Reç, me sipërfaqe 114 ha; ç) kullotat e Urës së Gjo Lulit dhe Domnit, me sipërfaqe 2200 ha.
Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", ku mund të ushtrohen veprimtari me karakter rikrijues, edukativ, ekoturistik, si dhe përdorimi tradicional i tokës, në harmoni të plotë me ruajtjen e natyrës dhe të vlerave shoqërore e kulturore të komunitetit vendas.
B.2. Zonë e zhvillimit tradicional e përbërë nga: territori që fillon nga fshati Pentar, në kufirin me Malin e Zi, vazhdon përmes kënetave të lumit Buna e kodrave të Rrencit dhe zbret në bregdet te Rëra e Hedhur, e cilësuar si korridor migrimi.
Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", por për karakteristikat që ofron, kërkohen plane të veçanta menaxhimi.
Zonë e tranzicionit e përbërë nga: plazhi i Velipojës, i kufizuar në Perëndim nga rezervati i Velipojës, në Veri nga rruga automobilistike dhe me shtrirje, në Lindje, deri në 500 m përpara kanalit të komunikimit të lagunës së Vilunit me detin.
Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura". Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari bujqësore, si dhe mund të përdoret toka për qëllime të ndryshme turistike, sportive, edukative, rikrijuese etj., që nuk cënojnë natyrën dhe biodiversitetin, mbështetur në zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore të zonës.
Ka një administratë të zonës së mbrojtur të Velipojës, e cila është e ngarkuar nga Ministria e Mjedisit që të kryejë edhe funksionet e administratës së peizazhit ujor/ tokësor të mbrojtur të lumit Buna.

Ishulli i Franc_ Jozefit është rezervat strikt natyror së bashku me zonën e rezervatit të Velipojës. Ky rezervat është shpallur i tillë dhe është një brez natyror me shumë vlera.

Zonat e lagëta si Delta e Bunës dhe grykëderdhja e saj si dhe pjesa veriore dhe verilindore e Lagunës e Vilunit janë shpallur në 2005 Zonë Ramsar.

Rezervati natyror i menaxhuar i Velipojës.
Për vlerat e tij, ky rezervat është një pasuri e rallë. Nuk ka pasur shumë dëmtime në të, pasi ai ka qenë me kohë rezervat, megjithatë duhet të punohet për tu frekuentuar më shumë nga turistët vendas dhe të huaj që mund të jenë edhe një burim i konsiderueshëm të ardhurash për komunën. Rezervati kufizohet nga veriu me toka bujqësore. Nga jugu me detin Adriatik, nga lindja me nje rrugë që të çon në plazhin e Velipojës dhe nga perëndimi me Lumin Buna.

1.3.3 Menaxhimi i zonave të mbrojtura
Administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur të Velipojës, e cila është në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, është e ngarkuar që të kryejë funksionet e administratës së peizazhit ujor/tokësor të mbrojtur të lumit Buna.
Rregullorja e administrimit si dhe plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur janë detyrë e MMPAU dhe organeve të pushtetit vendor.
Menaxhimi i zonës së mbrojtur siguron hartimin e një sërë planveprimesh dhe

ndërhyrjesh në drejtim të përkujdesjes dhe mirëadministrimit të burimeve natyrore në zonë. Krijimi i strukturave menaxhuese siguron jo vetëm zbatimin e shkallës së mbrojtjes, që është e lidhur me rritjen e potencialeve natyrore të zonës, por edhe rritjen e potencialeve ekonomike dhe turistike në zonë. Zhvillimi i zonave të mbrojtura dhe menaxhimi i drejtë i tyre, sigurojnë zhvillimin e alternativave turistike dhe hedhin një dritë të re mbi zhvillimin e premisave për ekoturizmin.

Një rëndësi të veçantë merr menaxhimi i zonave të lagëta në zonë dhe menaxhimi i llojeve dhe i habitateve me pjesëmarrjen e komunitetit. Laguna e Vilunit dhe zona e Velipojës në tërrësi mbart vlera të mëdha potenciale për turizmin veror dhe dimëror. Ekzistojnë të gjitha mundësitë e një menaxhimi shumë fitimprurës për banorët e zonës. Plazhi i virgjër pranë fshatit Baks-Rrjoll është ranor deri në zonën e "Ranës së Hedhun", pastaj ai vazhdon si breg shkëmbor deri në Shëngjin.
Prania e një maje intereante rreth 550 metra e lartë e quajtur Maja e Zezë, krijon mundësinë e kombinimit të tipeve të ndryshme të turizmit atij bregdetar (balnear) me atë malor.

1.3.4 Pyjet

Pyjet rriten në thellësi të tokës afër lagunës si dhe brigjeve të Bunës. Bimësia është kryesisht shkurrore dhe drunore. Në Lagunë pjesa perëndimore është e pyllëzuar. Pjesa lindore afër kodrave të Rrençit është për momentin e shpyllëzuar për shkak të ndërhyrjes së njerëzve si dhe prerjes. Pjesa më e madhe e pyjeve shtrihen në zonën e Rezervatit. Grumbujt e marinave ndodhen aty këtu nëpër ujin e cekët të kënetave. Këto janë gjithashtu një habitat shumë i mirë për shpendët si çapka dhe karabullakë.
Pylli gjithashtu përmban një shkurretë si dhe cungje (zonë në rigjenerim) me një sipërfaqe rreth 170 ha. Një sipërfaqe e madhe e pyllit të rezervatit ndodhet në pjesën veriore të rezervatit me drurë si verri, frashëri, rreth 180 ha me pishë dhe plep kanadez. Në këtë habitat pyjor takohen edhe bimë të rralla dhe të kërcënuara si rrënja, salepi, harvalina, zambaku i detit. Pyjet krijojnë korridore që lidhen njeri me tjetrin dhe të krijojnë mundesinë e vrojtimit nga afër të bukurive të Rezervatit të Velipojës dhe të derdhjes së Bunës në afërsi të tij. Jeta e pyjeve në stinën e ftohtë sidomos gjallërohet nga shpendët që vinë për të dimëruar në zonën e Velipojës.
Në vitet e fundit një sipërfaqe e konsiderueshme e pyjeve të zonës së Rezervatit dhe të Lagunës së Vilunit i është nënshtruar një shfrytëzimi të pakontrolluar të lëndës drusore, të shfrytëzimit të habitateve dhe të bimëve të nënpyllit sidomos të atyre mjekësore.
Ndërtimet në pyllin me pisha kanë zvogëluar së tepërmi sipërfaqen me pisha në një sipërfaqe rreth 19 ha. Gjendja e këtyre sipërfaqeve pyjore është në përkeqësim. Ka pak ndërhyje, të cilat synojnë rigjenerimin e sipërfaqeve të pyjeve. Në përgjithësi gjendja e pyjeve në zonën e Velipojës dhe në zonën e deltës së Bunës paraqitet në përkeqësim.

1.3.5 Erozioni

Detar: Dukuria e erozionit detar është më e dukshme gjatë bregut detar të lagunës së Vilunit dhe në derdhjen e lumit Buna. Përgjatë bregdetit hyrja e detit është rreth 2 metra sidomos afër grykëderdhjes së Bunës. Me këtë avancim humbja e bregut mund të jetë shumë më e madhe sesa ajo e llogaritur mesatarisht në 50 vitet e fundit deri 500 metra. Një ndër shkaqet kryesore për përparimin e detit dhe rritjen e erozionit është bllokimi i aluvioneve që vinin nga lumi Drin dhe ndërtimi i hidrocentraleve në shtratin e tij.
Ende nuk ka masa konkrete për mbrojtje, madje, po dëmtohet një nga mbrojtësit natyror të bregut, pylli me pisha, sidomos përgjatë bregut të Velipojës. Përgjatë

brigjeve të Bunës sidomos në zonën e Shirqit dhe të Obotit është i dukshëm një erozion i theksuar i tokave buzë brigjeve. Kjo ka çuar edhe në dëmtimin e brezave të tërë pyjorë përgjatë tyre.

Tokësor: Erozioni sipërfaqësor i tokës në zonë shkon deri 25 ton për ha në vit. Degradimi i tokës së punueshme për shkak të erozionit dhe përmbytjeve vazhdon të jetë një nga problemet më të mëdha në zonën e Dajçit dhe të Shirqit. Rënia e vegjetacionit, moskultivimi i tokës, metodat e papërshtatshme të ujitjes janë disa nga faktorët përshpejtues të këtij fenomeni në zonë. Zona të veçanta përdoren për kullotje, në kundërshtim me çdo lloj kriteri, duke stimuluar mbipërdorimin e bimësisë dhe për pasojë rritjen e erozionit dhe dëmtimin e pejsazhit.

Lumor: Shumë problematike paraqitet gjendja përgjatë lumenjve Drin, Buna dhe Kir. Vetë lumenjtë dhe aktiviteti njerëzor (nxjerrja e zhavorreve, dëmtimi i pritave malore etj) kanë shkaktuar probleme shumë të rënda përgjatë brigjeve të lumenjve. Kjo gjendje ndikon në shtimin erozionit bregetar dhe të brigjeve të lumenjve.

1.4 Zhvillimi i Turizmit, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit

1.4.1 Përshkrimi i përgjithshëm

Territori i Velipojës, është një ndër perlat e natyrës shqiptare ku gërshetohen harmonishëm deti me ujin e pastër, rëra e pashfrytëzuar dhe kurative, pylli, laguna, mali, fushat pjellore dhe kodrat e buta në të cilat gjenden shenja të vendbanimeve të hershme. Ajo është dalja e vetme në det për Qarkun dhe ka shërbyer si urë lidhje e qytetit të Shkodrës me vende të tjera, përmes lumit të Bunës. Rreth vitit 1890 nga austriakët në Pulaj, në grykderdhjen e Bunës, u ndërtua një port për anije të vogla, i cili ka funksionuar deri në fillim të luftës së parë botërore. Përmes këtij porti Shkodra ka bërë tregëti me Austrinë për disa vite. Nëpër lumë shpesh kanë lëvizur banorët e zonës me mjete lundruese të thjeshta për tu lidhur me qytetin e Shkodrës për tregëti ose nevoja të tjera. Dikur lumi Buna, ka qenë një rrugë komunikimi me qytetin e Shkodrës, madje ka pasur një liman ku janë ankoruar anije që lidhnin qytetin me përtej detin. Rreth viteve 1800-1900 komunikimi i Shkodrës përmes lumit Buna ka qenë shumë i rëndësishëm, ekzistenca e një pazari shumë të zhvilluar te Ura e Bunës në hyrje të Shkodrës flet më së miri dhe për rëndësinë e komunikimit përmes këtij lumi i cili rreth 14 km i përshkon në territorin e komunës Velipojë. Buna është pasuri e jashtëzakonshme me vlera ekonomike, sociale dhe turistike.

Ndër fushat prioritare të zhvillimit ekonomik për Velipojën, zhvillimi i turizmit, është objektivi nr 1. "Turizmi detar, lumor dhe malor, ndërtimi i limaneve në Lumin Buna dhe Lagunën e Vilunit, ndërtimi i fshatrave turistike në Baks Rrjoll dhe Majën e zezë, janë synime ambicioze të Komunës Velipojë" [2)].

Rëra e Velipojës ka qenë e njohur për vlerat e saj kuruese. Në vitet 1969-1970, krahas shtëpive private, filloi nga shteti ndërtimi i dy hoteleve dhe disa kabinave. Deri në vitet 90, në Velipojë, zhvillohej një turizëm masiv, me një numër të kufizuar pushuesish . Katër hotele dhe disa gabina të thjeshta, të gjitha pronë e shtetit ishin ndërtimet e vetme në plazhin e Velipojës. Banorët e fshatit nuk pengoheshin të lëshonin dhoma në shtëpitë e tyre për pushuesit kundrejt një pagese të arsyeshme. Pas viteve 1993, me privatizimin e ndërmarrjeve bujqësore, banorët morën tokën bujqësore dhe

2 Strategjia e Zhvillimit të Komunës Velipojë e vitit 2006, përgatitur nga komuna Velipojë.

njëkohësisht vendosen kufijtë në pronat e trashëguara. Njerëz të interesuar, blenë parcela toke pothuajse në gjithë territorin e plazhit nga ishpronarët, dhe persona të tjerë, të cilët kishin zaptuar sipërfaqe "pa pronar". Si rrjedhojë u krijuan sheshe ndërtimi, dhe filluan të mbijnë ndërtimet e hoteleve, shtëpive të dyta për qytetarët dhe "lulëzoi tregu i trojeve". Tashmë pothuajse s'ka mbetur tokë pa u shitur ose zënë. Toka u coptua në parcela për ndërtim nga 100 m2 deri në parcela 2000–3000 m2. Familjarët rindërtuan shtëpitë e tyre duke i përshtatur përgjithësisht në vila komode.
Aktualisht plazhi i Velipojës, (emri zyrtar i fshatit Pulaj Bregdet), ka një popullsi prej 1082 banorë, prej të cilëve rreth 50%, të ardhur në 5-6 vitet e fundit, në 4 muajt e sezonit veror frekuentohet prej rreth 10 mijë pushues që akomodohen dhe alternohen përgjithësisht në periudhë 15 ditore dhe rreth 15-20 mijë pushues ditor. Në ditët e shtuna dhe të diela pushuesit ditor kalojnë shifrën 40.000 personave.
Duke e menduar si një biznes të leverdishëm janë ndërtuar mbi 100 hotele me 6-30 dhoma dhe lokale shërbimi. Gjithashtu, funksionojnë edhe rreth 80 lokale shërbimi, bare dhe restorante, ndërtime të reja, të ngritura mbi bazë të preferencave dhe planeve personale për ndërtim dhe të pakordinuara për zhvillimin prespektiv të zonës turistike të Velipojës.
Territori i Velipojës, ka 14 km vijë bregdetare, e cila fillon nga grykëdredhja e lumit Buna deri tek Rëra e hedhur. Gryka e komunikimit të Lagunës së Vilunit me detin e ndan plazhin e Velipojës në dy pjesë : në atë të Velipojës (6 km), i përdorur si plazh 3.700 ml me një gjendje kaotike zhvillimi dhe, në Plazhin e Rrjollit (8 km), ku sapo kanë filluar betonimet.

Përmes rrugës automobilistike në Velipojë, kalohet në Urën e Gjon Lulit, e cila mund të konsiderohet e vetmja rrugë komunikimi me Shkodrën dhe më gjerë.

Ultësira e kësaj zone përfshin Malin e Majës së Zezë, 454 m mbi nivelin e detit, dhe tre kodra që vendasit i quajnë mele: Mali i Martinit, Mali i Bajzës dhe Mali i Reçit, terrene, të cilat me veçantitë e tyre gjeografike dhe historike ia shtojnë vlerat turistike Velipojës. Gjithashtu, tre kanale dhe dy hidrovore të fuqishme të ndërtuara për kullimin dhe largimin e ujërave të tepërta, janë arteriet që lidhin Lagunën e Vilunit me fushat dhe zonat e ulëta kënetore, të cilat jo vetëm që kanë veçantitë e tyre, por janë habitate të llojeve të ndryshme të peshkut dhe të shpendëve migratore apo të përhershëm.
Komuna ka rreth 1.000 ha me pyje nga të cilat rreth 639 ha është rezervat i mbrojtur. Aty rritet një shumëllojshmëri flore dhe faune, përshkimi i pyllit prej portës së hyrjes së tij deri në grykëderdhjen e Bunës është kënaqësi e veçantë.

1.4.2. Llojet e turizmit

Natyra i ka falur Velipojës, në një territor relativisht jo shumë të madh detin, rërën, lagunën, malin, pyllin, dunat e rërës dhe fushat pjellore, ujëra të ëmbla të pasura me peshk etj. Këto i japin asaj mundësinë e zhvillimit të disa llojeve të turizmit. Pushimet në bregdetin e Velipojës, janë atraksion i rëndësishëm për të ardhurit. Muaji maj, por veçanërisht, gjysma dytë e muajit qershor, e shndërrojnë plazhin e Velipojës, nga një zonë rurale, ku pothuajse vetëm ndërtohet, në një qendër mjaft të populluar. Në gjysmën e dytë të korrikut dhe gjatë muajit gusht plazhi i Velipojës është në pikun e frekuentimit si nga pushuesit rezidentë, në hotele e familje ashtu dhe pushues ditorë kryesisht nga zona veriore dhe qendrore e Shqipërisë. Plazhi i Velipojës është 130 km larg Tiranës.
Duke pare larminë e terrenit, klimën, florën, faunën, larminë e kulturave, mund të aplikohet jo vetëm turizëm për pushime në bregdet, por dhe lloje të tjera të turizmit dhe argëtimit.Nga kërkimi i bërë nga studentë të universitetit të Shkodrës në të 10

fshatrat e komunës Velipojë, nën logon ''Fshati ynë ka të ardhme turistike'' u nxorën në pah burimet turistike natyrore, historike, kulturore, promovimi i të cilave e bën Velipojën më interesante për turistët.

1.4.2.1 Turizmi në bregdet me banja dielli dhe uji

Turizmi në plazhin e Rrjollit, në shtëpitë e banorëve të fshatit ose në banesa me konstruksione të lehta, mund të kordinohet me hipizëm, ngjitje alpinistike shëtitje në natyrë, shëtitje me varkë, etj., shëtitje në natyrë në Majën e Zezë, vazhdim i Malit të Rencit, mal i ngritur thikë mbi det, shëtitjet përgjatë bregut të Bunës me këmbë ose me varka, etj. Shëtitjet në natyrë në rezervatin e pyllit të Velipojës janë shumë çlodhëse. Aty janë të ndërtuara pika vëzhgimi prej të cilave mund të sodisësh peizazhin dhe zogjtë e shumtë të pyllit dhe të kënetave të vogla në brendësi të rezervatit. Pothuajse në të gjithë territorin e Velipojës dhe në të gjithë stinët mund të vëzhgosh zogjtë e shumtë migratorë dhe të përhershëm të zonës. Kujdes duhet bërë në zona të caktuara ku zogjtë riprodhohen dhe kanë foletë e tyre duhet shmangur prania e njerëzve
Sporti i peshkimit me grep mund të aplikohet si në ujërat e ëmbla të brendshme të lumit, lagunës e kanaleve dhe në det.
Në sezonin gjuetisë, gjuetia e kafshëve të egra dhe sidomos e shpendëve është mjaft argëtuese, por për këtë lloj argëtimi duhet të merren masa tejet të rrepta në varësi të planeve të menaxhimit dhe jetës biologjike të llojeve, gjë e cila deri më tani ka qenë jashtë kontrolli.

1.4.3. Infrastruktura turistike dhe superstruktura në shërbim të turizmit

Plazhi i Velipojës, lidhet me qytetin e Shkodrës përmes degëzimit të rrugës kombëtare Tiranë-Shkodër me një rrugë të rikonstruktuar 4 vitet e fundit në distancën 30 km. Me përfundimin e rikonstruksionit të rrugës Shkodër-Velipojë, problem mbetet zgjerimi i dy urave relativisht të gjata, të cilat janë me një kalim dhe shpesh shkaktojnë vonesa të gjata për të lëvizur drejt Velipojës.

Rruga kryesore është me dy korsi, vajtje ardhje, e cila vijon përmes fushave të nënShkodrës, prek fshatrat Bërdicë dhe Trush dhe hyn në zonën e Velipojës përmes Urës se Gjolilit. Rruga përshkon 5 fshatra të komunës, Malin e Kolajve, Baksin e Ri, Gomsiqen e Re (qendra zyrtare ku ndodhen dhe zyrat e komunës), fshatin Velipojë e Re dhe mbërrin në Plazhin e Velipojës. Katër fshatrat hyrës nevojitet të trajtohen si vendbanime paraprezantuese të zonës turistike, pasi këtu mund të akomodohen pushues në familjet e fshatarëve .

Largësia e Plazhit nga Mali Kolaj është 12 km, nga Baksi i Ri 6 km, nga Gomsiqja e Re 6 km dhe nga Velipojë 2 km. Katër fshatrat e tjerë të Komunës Çasi dhe Luarzi, Reçi i Ri dhe Reç Pulaj, lidhen me rrugën që të çon në plazh me rrugë rurale, të cilat kanë nevojë për asfaltim pjesor (Qendër Luars, Varri i Hasanit-Ças në 8 km dhe pjesa tjetër Misuke- Reçi i Ri), vazhdimi për Reç Pulaj ka nevojë për rikonstruksion dhe asfaltim 6 km. Në plazhin e Velipojës nga fshati Baks i Ri mund të shkohet dhe me lundra të vogla, përmes kanalit të kullimit të ujërave të fushave që derdhet në Vilun, gjithashtu nga fshati Luarz dhe nga Reç Pulajt mund të shkosh në plazh duke lundruar nëpër lumin Buna.

1.4.4 Njësitë akomoduese

Janë rreth 80 hotele me kapacitet nga 6 - 30 dhoma, që shërbejnë për akomodimin e pushuesve në Plazhin e Velipojës. Kapaciteti akomodues rreth 12.000 persona. Hotelet përgjithësisht janë të ndërtuar si mjedise banimi ku mund të akomodohen 4-5 persona me dhomë, aneks, banjë e tualete. Në këto mjedise, familjarëve zakonisht

u lejohet të gatuajnë dhe ushqehen. Ato plotësojnë kushtet optimale të kërkesave të pushuesve, si rregull ato jepen për 14 ditë me çmime që variojnë nga 15.000 Lekë në muajin qershor deri në 35-45 mijë Lekë, në muajt korrik-gusht, dhe njësitë akomoduese që ofrojnë ushqim, 70 deri 90 mijë Lekë për familje me 4 persona për 14 ditë.
Territori i plazhit ka popullsi 1.200 banorë, 700 prej të cilëve janë të ardhur zyrtarisht në 10 vitet e fundit. Në qendër të plazhit ka një ambulancë publike që funksionon vetëm në periudhën e verës, nuk ka shkollë, fëmijët e këtij fshati shkojnë rreth 4 km larg, në fshatin Velipojë për të marrë arsimin fillor dhe 9 vjeçar. Në verë funksionojnë lokale shërbimi si bare, restorante, kafe, rrjet tregtar i cili plotëson nevojat e pushuesve. Në sezonin veror prej tre vjetësh funksionon një treg ambulant për prodhime bujqësore e blegtorale të fermerëve vendas, treg i cili ka dhënë efekte pozitive në drejtimin e disa fermave të vogla, të cilat po drejtojnë prodhimin e tyre drejt plazhit duke shtuar llojshmërinë, rritur sasinë dhe përmirësuar cilësinë e produkteve sipas nevojave të tregut. Përgjithësisht mungojnë njësitë e shërbimit komunal. Funksionon posta ambulante dhe fotografi, por mungon shërbimi bankar dhe i transfertave të ndryshme. Mungesa e kulturës së jetesës në komunitet, bën që vlera e investuar në njësitë akomoduese, të degradojë nga mungesa e rregullit në mjediset e përbashkëta me papastërti, gropa me baltë, me kafshë shtëpiake etj.

1.4.5. Vizitorët vitet e fundit

Vit pas viti, numri i vizitorëve që frekuentojnë Velipojën është rritur. Pothuajse çdo vit përfundojnë ndërtimin dhe janë të gatshëm për t'u dhënë me qera 10-12 objekte, duke u shtuar kapaciteti akomodues me gati 250 deri 300 shtretër (një dhomë përgjithësisht funksionon me 4 shtretër). Në vitin 2005, krahasuar me një vit më parë numri i pushuesve të akomoduar u rrit me rreth 10 %, u zgjerua koha e zënies së hoteleve me kapacitet të plotë në 16 korrik - 15 gusht. Në vitin 2006 numri i pushuesve të akomoduar pati rënie, madje dhe në dy 15 ditorët pik, pati hotele të pa zëna megjithëse vitin e fundit numri i pushuesve ditorë është rritur ndjeshëm. Nga vrojtimi i bërë rezulton se pjesa e plazhit prej 4 km nga gryka e Vilunit deri te Plazhi i Velipojakëve, ish plazhi i rezervuar për udhëheqjen e dikurshme, vitin e fundit (2006), ka qenë totalisht i mbushur me pushues me dendësi të lartë në qendër dhe dendësi mesatare në të dy krahët. Nuk ka ndonjë studim të numrit të pushuesve në plazhin e Velipojës, por nga përllogaritjet e përafërta në ditët e zakonshme mund të jenë 25 deri 30 mijë pushues ndërsa në ditët pik, të shtuna dhe të diela, ky numër mund të kalojë shifrën 50 mijë pushues. Vitin e fundit përgjatë rërës janë ndërtuar disa pika vrojtimi, të cilët ndihmojnë pushuesit në rast të rrezikut në det ose nevoja emergjente. Ato funksionojnë me mjete vëzhgimi dhe lidhen me qendrën e tyre me sistem radioje, kanë mjete të ndërhyrjes shpejtë në ujë, skaf dhe në rërë, me mjete dhe kuaj.
Si rrjedhojë e përmirësimit të kushteve të udhëtimit dhe të promovimit të plazhit Velipojës dhe në panairet e ndryshme si në atë të Prishtinës dhe të Shkupit, ky plazh prej tre vitesh frekuentohet ndjeshëm dhe nga pushues nga rajone të Kosovës. Kryesisht Velipojën e frekuentojnë pushues vendas nga rajonet e Shkodrës. Nga intervistimi i disa pushuesve në plazh, 92 % e tyre e frekuentojnë Velipojën për natyrën e saj, detin dhe rërën, pjesa tjetër për qëllime biznesi, vizita të afërmve, etj[3]. Mangësitë në infrastrukturën rrugore dhe mungesa e vendeve të argëtimit, bëjnë që Velipoja të frekuentohet ndjeshëm vetëm 3-4 muaj të vitit.
Funksionimi i plazhit në Velipojë, ka ndikime të shumta ekonomike dhe sociale. Duke ndjerë nevojën e tregut për produkte bujqësore dhe blegtorale, disa ekonomi fshatare prodhojnë për tregun e plazhit ose më të shumtit, tregtojnë një pjesë të produkteve të ekonomisë së tyre bujqësore në këtë treg kjo bën që të rriten të ardhurat nga bujqësia.

3 Workshopi në Shkodër për konceptet e zhvill rajonal, tetor 2005

Vitet e fundit, ndërtimi është bërë sektor i rëndësishëm punësimi dhe të ardhurash jo vetëm për banorë të zonës, por dhe të zonave përreth e qyteti i Shkodrës. Në aktivitetin e ndërtimit në Velipojë marrin pjesë dhe punëtorë nga rrethinat e afërta të Shkodrës, duke lëvizur çdo ditë për në shtëpitë e tyre. Aktiviteti i ndërtimit të objekteve është pothuajse gjithë vjetor dhe në të përfshihen grupe pune me 3-10 veta. Janë rreth 15 grupe ndërtuesish që operojnë në plazhin e Velipojës, pothuajse 70 % e vitit.
Në sezonin e verës në muajt maj- gusht krahas personave që vetëpunësohen familjarisht në rrjetin tregtar, një numër i madh punësohet në lokalet e shërbimit, kryesisht të rinj dhe në hotele gra. Numri i të punësuarve në këto sektorë në tre vitet e fundit ka ardhur në rritje ku për vitin e fundit janë punësuar rreth 100 persona, në profesione kamerier, punëtor pastrimi, etj. Gjithashtu, në tre vitet e fundit ka funksionuar një brigadë pastrimi e komunës me rreth 30 punëtorë me kontratë sezonale për periudhë 4 mujore.

1.4.5. Informimi i publikut.

Në zhvillimin e turizmit përfshihet dhe informimi i publikut si për sa i përket perspektivës së zhvillimit të mëtejshëm të zonës dhe për informacionet e nevojshme të orientimit, të gjetjes së një lokali, hoteli, një dhome për të pushuar apo për të takuar një mik a të afërm. Publiku nuk është njoftuar për masterplanet e miratuara për plazhin. Mungojnë qendrat për informim të publikut, hartat orientuese dhe nuk ka një qendër të informacionit dhe as tregues qarkullimi për të marrë informacionin e nevojshëm gjë që e bën të vështirë orientimin në rast nevoje. Hotelet dhe baret përgjithësisht kanë emrat e tyre ndërsa rrugët, rrugicat dhe sheshet ende nuk kanë një emër simbolik që do t'i shërbente një orientimi më të shpejtë për vizitorët. Në Velipojë kryen shërbimin telefonik fiks një kompani private, e cila aktualisht operon me tarifa relativisht të larta telefonike dhe nuk ofron shërbimin e internetit. Disa informacione të nevojshme mund të merren nga disa materiale promovuese të komunës, nga punime të disa OJF ve, etj.

1.4.6 Arsimi

Komuna ka 2 shkolla 9 vjeçare dhe 4 shkolla fillore. Numri i nxënësve të shkollës është 1.119, nga të cilët 177 janë nxënës që vazhdojnë shkollën e mesme[4)]
Që nga viti 1974, në Velipojë, ka një shkollë të mesme, e cila fillimisht ka pasur profil bujqësor, ndërsa tashmë është e profilit të përgjithshëm. Në çdo vit përfundojnë arsimin e mesëm rreth 50 nxënës. Programet e shkollës prekin edukimin mjedisor, përfshirja e nxënësve në aktivitete të tilla që trajtojnë vlerat natyrore, ekologjike dhe ekonomike të Lagunës së Vilunit dhe rëndësia e ruajtjes se tyre, vlerat e brezave të gjelbër dhe ndikimi i tyre në mjedis, shëtitjet në pikat me vlera turistike, zbulimi dhe promovimi i tyre janë mekanizma që funksionojnë në shkollë. Më tepër duhet të punohet për edukimin mjedisor rreth kërcënimeve që i vijnë popullsisë nga dëmtimi i pasurive natyrore, territoreve, ujërave, pyjeve, etj. Edukimi duhet të synojë që fëmijët të jenë faktor ndikues në familje, për ruajtjen e vlerave të mjedisit, në administrimin e mbetjeve urbane, detyrimet e ndërsjella të jetës në komunitet. E nevojshme është hapja e një klase me drejtim turizmin.
Deri në vitin 1995, ishin 70 persona që kanë përfunduar arsimin e lartë, të profileve nga më të ndryshmet si specialistë të bujqësisë, të blegtorisë, ekonomistë, mësues, mjekë etj. Me masivizimin e universiteteve, numri i atyre që kanë përfunduar arsimin e lartë, e kalon shifrën e 100 personave dhe mjaft të rinj ndjekin universitetin. Ekonomia e tregut ka lënë jashtë profilit të tyre një numër të madh personash, që kanë përfunduar studimet e larta, dhe ata bëjnë shpesh punë të rëndomta. Rikualifikimi i tyre do të ishte një investim me vlerë.

4 Të dhëna statistikore të arsimit të shkollave të Velipojës, maj 2006

1.4.7 Atraksione turistike në Velipojë

Pasuritë kulturore.

- Popullsia mikpritëse e Velipojës;
- Të veçantat dhe ndërthurja e kulturave të të ardhurve të hershëm nga zona e Malësisë së Shkodrës, me popullsi të ardhur më vonë nga zonat e Dukagjinit, të Mirditës dhe të Postribës. Këto kultura, të cilat shfaqen dukshëm në gjuhën e folur, në veshje, në ceremonitë e dasmave dhe të vdekjeve etj., janë vlera për Velipojën, vlera të veçanta për një popullsi që bashkëjeton në territor kaq të afërt. Veshje të mirditorëve, veshje katundare, veshje malësore i ndesh jo vetëm në ceremoni familjare, por dhe në jetën e përditshme;
- Kuzhina e pasur veçanërisht me gatimin e peshkut, të shpendëve të egra, pastërmanë dhe turshitë, rakinë, verën etj.;
- Objektet e kultit, Kisha e Velipojës, Kisha e Rrjollit, Kisha e Reçit, Kisha e vjetër në Pulaj, Xhamia e Luarzit, mjediset kulturore e sportive pranë kishës.

Pasuritë natyrore

- Plazhi i Velipojës, (plazhi i madh sipas vendasve) 3.700 ml, me rreth 150 m rërë, gati 50 m shfrytëzohet për banja dielli, zakonisht për 4 deri 5 muaj në vit, por mund të shfrytëzohet dhe për 7 muaj për banja dielli dhe larje në det, duke u shtrirë si kohë nga prilli në tetor. Rëra e Plazhit rigjenerohet çdo vit nga baticat dhe zbaticat;
- 2.300 m në vazhdim të plazhit për të shkuar në grykën e Bunës, peizazh interesant në afërsi të pyllit me detin, me oaze të vegjël uji, të jep pamje shkretëtire.
- Plazhi i Rrjollit, rreth 8000 m, shumë kompleks, ende i panjohur dhe i pashfrytëzuar. Mali i Majës së Zezë ngrihet madhërishëm mbi det, duke të dhënë imazhin e bregut të Jonit. Dunat e rërës, pyjet e vogla me shkurre, rëra e hedhur, shpellat në rrëzë të malit janë elementë përbërës të kësaj zone turistike.
- Mali i Majës së Zezë me livadhe shumë të bukura, ku shpesh has tufa me kuaj që fshatarët i lëshojnë hergjele në mal. Pylli me drurë si lisi, shkoza, frashri etj., kanë bukuri të veçantë. Ngjitja në mal dhe zbritja mund të jenë të lodhshme, por të japin kënaqësi e mund të bëhen në disa rrugë këmbësore. Lagjja më e afërt me Majën e Zezë është Lulajt, në krahun veriperëndimor të malit.
- Bregu i Bunës, në 14 km e tij që përshkon Komunën e Velipojës, është një mrekulli e natyrës. Një shëtitje më këmbë, por sidomos një shëtitje me një mjet të vogël lundrimi do të shpalosë madhështinë e lumit që rrjedh ngadalë, mes dy brigjeve të mbushura me pemë, shpendët që fluturojnë aty këtu, në kërkim të ushqimit, peshqit që mund t'i vrojtosh në tufa duke lëvizur. Mund të rastisë të shohësh dhe delfinë duke kërcyer mbi ujë dhe të tjera supriza që ofrojnë mbresa të pashlyeshme.
- Grykëderdhja e Lumit Buna dhe dy ishujt, Ada, rreth 5 ha, që i përket Malit të Zi dhe Ishulli i Franc Jozefit, ishull që shpesh bashkohet me tokën, është një vend me pamje të mrekullueshme, ku krahas të tjerash mund të notosh dhe në ujin e detit dhe në ujin e lumit.
- Ullishta në Baks të Ri, ku mund të pushohet, madje dhe mund të organizohen piknikë ditorë. Prej aty, kundron mjaft pamje të Velipojës dhe zogjtë e shumtë madje dhe gardalina, bilbila, etj. Velipoja mund të konsiderohet si vend i veçantë për sportin e vrojtimit të zogjve nga lartësitë e kodrave, në lagunë dhe në pikat e vrojtimit në rezervat.
- Nga kodrat përreth, pamja shtrihet përtej Velipojës, horizonti i largët janë malet e Malsisë së Madhe, malet e Krujës e deri në Ulqin, mund të vëzhgosh pamjen

e plotë të Velipojës. Aty ka gjëra interesante: mbetje qeramikash në malin e Martinit, shpella dhe shenja varresh të vjetra (mogila) në Malin e Kolajt. Terreni është mjaft i thyer, me gurë gëlqerorë e shkrepa, aty mund të ndeshësh shpendë e kafshë të egra dhe të shikosh foletë e tyre etj;

- Laguna e Vilunit, kanali natyror i së cilës e lidh atë me detin, ndan plazhin e Velipojës nga ai i Rrjollit. Uji këtu ndryshon drejtim të komunikimit me detin, hyn ose del çdo 6 orë. Me gjithë larminë e saj është mjaft tërheqëse për shëtitje, peshkim dhe gjueti, ajo mund ta vizitosh në çdo periudhë të vitit dhe të shijosh bukuritë e saj;
- Kënetat, në brendësi të fushave, përvec peshkut dhe shpendëve, janë shumë të larmishme, me bimësi, kallama, pemë uji, ishuj të vegjël në mes të kënetës, etj.
- Rezervati i pyllit të Velipojës, 639 ha, me florë dhe faunë shumë të pasur, një pyll pothuajse i virgjër, i ruajtur shumë mirë.

Këto e shumë vlera të tjera historike, kulturore, natyrore, që ende nuk janë zbuluar e vlerësuar, janë pasuri të Velipojës, që, në këndvështrimin turistik, mund të marrin vlerësim të veçantë dhe ta bëjnë këtë zonë dhe më tërheqëse.

2. Lista e problemeve

Problemi a) Jep shprehur në sens negativ, duke përdorur fjalë që shprehin anën problemore të tij, si: zvogëlim, rënie, shkatërrim, humbje, etj;	**Shkaku/qet** (Listë shkaqesh qe sjellin problemi, që mund të jenë natyrore dhe njerëzore)	**Ndikimi** a) Jepet ndikimi negativ në: Mjedis, Shëndet, Mirëqenie, tjetër të identifikuar b) Për secilën nga ndikimet e mësipërme (kur është e mundur) jepet me përshkrim se si ndikon ky problem, duke treguar pasojën qe sjell, p.sh. rritjen e numrit të sëmurëve me sëmundje respiratore, etj.	**Popullsia që preket** a) Numri i banorëve ose nëse nuk mund të përcaktohet jepet me përqindje b) Ku është e mundur jepet ndarja sipas gjinisë dhe cila shtresë e popullsisë është më e prekur	**Shkalla e ndikimit** Vlerësohet me shkallën: a) E lartë; b) E mesme; E ulët; Për secilën nga nivelet e dhëna jepet arsyeja	**Prioritarizimi** I matur me shkallën: * = Pak i rëndësishëm ** = Mesatarisht i rëndësishëm *** = Shumë i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhershme)
1. Situata urbanistike: rritje të numrit të ndërtimeve pa leje (rreth 500 të tilla)	- Prani e disa masterplaneve, por të pazbatuara. - Ende e papërcaktuar nëse plazhi i Velipojës do të jetë një plazh turistik cilësor ose masiv - Plani i fundit Institutit të Studimeve Urbanistike nuk merr parasysh studimet paraprake për: mjedisin; infrastrukturën; nuk detajon procedimin në hapa të mëtejshme	- Ul ndjeshëm cilësinë e mjedisit; - Tjetërson në mënyrë të përhershme tokën duke e kthyer në geto ndërtimesh; - Ul në maksimum mundësinë për zbatimin e shërbimeve të nevojshme dhe rrit kostot e zbatimit të tyre; - Pengon mundësinë prioritare të zhvillimit të zonës, asaj turistike	- popullsia vendase (8270 banorë) - turistët vendas e të huaj që pushojnë	E lartë (pasi vazhdon situata kaotike e ndërtimeve pa leje)	* * *

2. Furnizim jo i plotë me ujë dhe me cilësi në nivele të padëshiruara.	- Rrjeti është shumë i amortizuar - Disa fshatra ende nuk kanë sistem	- Mungesa e ujit të pijshëm të kontrolluar çon në rritjen e të sëmurëve me sëmundje infektive; - Rrit shpenzimet e konsumatorëve për blerjen e ujit të pijshëm	- popullsia vendase (8270 banorë) - turistët vendas e të huaj që pushojnë	E mesme (rrit shpenzimet e konsumatorëve për blerjen e ujit të pijshëm)	* *
3. Të ardhurat e komunës nga taksat/ tatimet në vitin 2005 në krahasim me vitin 2004 shënojnë rënie	- Punë jo e mirë e punonjësve të komunës për grumbullimin e taksave dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për pagesën e detyrimeve ndaj pushtetit vendor.	- Më pak investime në zonë në lidhje me infrastrukturën , mjedisin që ndikon në rritjen e mirëqenies së komunitetit	- popullsia vendase (8270 banorë) - turistët vendas e të huaj që pushojnë	E lartë (çon në mungesë investimesh)	* * *
4. Mungesa e sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza	- Mungesë e planeve të mirëfillta urbane ku të jenë të parashikuara dhe ndërtimi i këtyre sistemeve. - Mungesë totale e fondeve për studime dhe ndërtime të këtyre rrjeteve.	- Rrit rrezikun e ndotjes së mjedisit - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave që përdoren për t'u pirë. - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave nëntokësore	- E gjithë komuna - Pushuesit dhe vizitorët e zonës	E lartë	* * *

5. Mungesa e një impianti të përpunimit për ujërat e zeza	- Mungesë e fondeve për studime dhe investimin - Mungesë bashkëpunimi ndërinstitucional	- Pengon zhvillimin turistik dhe ul ndjeshëm imazhin e zonës; - Rrit rrezikun e ndotjes së mjedisit - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave që përdoren për t'u pirë. - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave nëntokësore	- E gjithë komuna - Pushuesit dhe vizitorët e zons	E lartë	* * *
6. Ndotja e ujit dhe rërës prej mungesës së baterive të banjove publike në plazh.	- mungesa totale e banjave publike në bregdet dhe në mjediset publike të plazhit. - mungesa e fondeve për studimin dhe ndërtimin e tyre	Rrit rrezikun e ndotjes së ujit të detit dhe të rërës. Rrit rrezikun e sëmundjeve të lëkurës dhe infektive Dëmton rëndë imazhin e turizmit. Shkakton pakënaqësi të madhe tek pushuesit	- E gjithë komuna - Pushuesit dhe vizitorët e zonës	E lartë	* * *
7. Shtim i sasisë së mbetjeve urbane	- Rritja e dendësisë së popullsisë sidomos pranë zonës bregdetare - Numër i madh pushuesish, në rritje - Rritje e konsumit	- grumbullim i sasive të mëdha të mbetjeve - qëndrim për kohë të gjatë në pikat e grumbullimit - dekompozim i mbetjeve urbane në pika të hapura - vështirësi në largimin e tyre	- E gjithë komuna - Pushuesit dhe vizitorët e zonës	E lartë	* * *

8. Grumbullim i sasive të mëdha të mbetjeve	- Rritje e konsumit - Kulturë relativisht e varfër e komunitetit - Mungesë fondesh për evadimin e tyre - Mungesë fondesh për realizimin e projekteve te mirëfillta	- vështirësi në evadimin e tyre - qëndrim për kohë të gjatë në pikat e grumbullimit - dekompozim i mbetjeve urbane në pika të hapura - rrit rrezikun për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse infektive, alergjike e azmatike. - ndotje e ujërave nëntokësore - ndikim negativ në faunë. - prishje peisazhi natyror dhe ndikim negativ në turizëm	- E gjithë komuna - Pushuesit dhe vizitorët e zonës	E lartë	* * *
9. Mungesa e një fushe sanitare të grumbullimit të mbetjeve	- Mungesa e planeve të përgjithshme dhe të posaçëm për vendet e hedhjes së mbetjeve. - Probleme të pronësisë mbi tokën - Mungesë përvoje në menaxhimin e mbetjeve urbane. - Kulturë relativisht e varfër e komunitetit - Kapacitete jo të mjaftueshme dhe të përshtatshme - Mungesë e fondeve për studime dhe investime	- Në shëndetin e komunitetit, duke rritur mundësinë e rritjes së infeksioneve prej dekompozimit të mbetjeve urbane në pika të hapura - Në ndotjen e mjedisit me rrjedhojë ndotjen e ajrit, të ujit, etj - Dëmtime të ekosistemeve - Ndikim negativ në ekonomi, në zonat turistike, menaxhimi i keq i ndotjeve urbane largon turistët. - Rrezik i përhapjes së sëmundjeve dhe epidemive	- E gjithë komuna - Pushuesit dhe vizitorët e zonës	E lartë	* * *

10 Problemet e pronësisë mbi tokën	- Deformime të ligjeve për tokën bujqësore dhe pronat - Apatia e pushtetit lokal dhe qendror në zgjidhjen e problemit të pronave - Mospajisja e pronarit të tokës me dokumentet e pronësisë	- Copëtimi i tokës në sipërfaqe të vogla duke u shitur si troje - Dëmtim i brezave pyjorë duke i degraduar ato në troje - Konflikte të hapura sociale	E gjithë komuna	E lartë (mbetet problemi kryesor pengues për zhvillimin e zonës dhe fillimin e zbatimit të masterplaneve)	***
11. Mangësi në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese	- Mungesa e fondeve	- Ul ndjeshëm rendimentet prodhuese; - Shkak për përmbytjen e tokave dhe degradimin e tyre	Të gjithë fermerët e komunës	E lartë	***
12. Copëtimi i parcelave të tokave bujqësore në parcela shume të vogla	- Probleme të pronësisë mbi tokën - Mungesa e bashkëpunimit mes fermerëve për sistemime të parcelave.	- Mungesë e një mekanizimi të përqendruar; - Dëmtim i mjedisit në shkallë më të lartë, si rezultat i mbishfrytëzimi dhe keqshfrytëzimit.	I gjithë komuniteti i komunës	E mesme	**

13. Rënia e vlerave të larmisë biologjike në zonë, përmes: a. pakësimit të sipërfaqeve pyjore b. zvogëlimit të numrit të llojeve të bimëve mjekësore c. shtimit të listës së numrit të llojeve të bimëve dhe kafshëve të rrezikuara d. zvogëlimit të numrit të shpendëve që folezojnë në lagunë dhe në pyje e. rëniesa së burimeve peshkore f. dëmtimit të habitateve si tharja e kënetave dhe prerja e kallamishteve g. urbanizimit të zonës gj. Mungesës së një plani për zhvillimin e rajonit, ku të përfshihet ruajtja e vlerave natyrore dhe e biodiversitetit. h. mungesës së kulturës mjedisore dhe e ndërgjegjësimit të banorëve të rajonit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit. i. mungesës së ndërgjegjësimit të pushuesve për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit.	- shfrytëzimi i lëndës drusore për djegie - prerje e pyjeve për sipërfaqe ndërtimi - mbishfrytëzim i llojeve të bimëve mjekësore dhe tregtia e shfrenuar e tyre - prishja e habitateve të shpendëve - ndotja e ujërave të lagunës së Vilunit dhe kënetës së Domnit - gjuetia e shpendëve jashtë sezonit - peshkimi i paliçencuar - zhvillimi i turizmit masiv në Velipojë - mungesa e planeve të veprimit për ruajtjen e llojeve - mungesa e qendrave të informimit të edukimit mjedisor në zonë	- Zvogëlimi i vlerave të biodiversitetit. me pasoja në rënien e të ardhurave, vlerat etike që humbasin me humbjen e llojeve. - Ulet interesi i njerëzve për të vizituar zonën dhe për ta eksploruar atë. - Prishet peizazhi duke u prishur dhe shkatërruar habitatet. - Zvogëlohen mundësitë e shfytëzimit të zonës si një zonë me vlerë dhe me potencial turistik.	Gjithnjë më të prekurit mbeten banorët e zonës së Sektorit Velipojë, zonës së Plazhit dhe zonës Baks-Rrjoll. Duke pasur parasysh faktin se delta e Bunës është e shtrirë në disa fshatra të Komunës së Dajçit që lidhen në zonën e Kënetës, atëherë numri i banorëve të ndikuar rritet.	E mesme. Banorët kanë edhe burime të tjera të jetesës të lidhura me vlerat e biodiversitetit siç mund të jenë zhvillimi i turizmit dhe sidomos premisat e zhvillimit të atij ekologjik.	**

14. Keqmenaxhimi i zonave të mbrojtura, përmes: a. zvogëlimit të sipërfaqeve të habitateve pyjore dhe dëmtimi i habitateve ujore brenda territorit të zonës së mbrojtur b. strukturës administrative për menaxhimin e zonës se mbrojtur së pamjaftueshme dhe me mungesa në logjistikë c. zvogëlimit të numrit të llojeve bimore dhe shtazore sidomos lagunë dhe në pyje d. cënimit të rëndë të vlerave ekoturistike të rajonit nga dëmtimet pa leje e. mungesës së planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur	- Mungesa e shkallës së mbrojtjes për një kohë të gjatë - Administrata e kufizuar dhe mungesa e menaxherëve mjedisorë brenda këtyre strukturave, - Mungesa e vullnetit politik për të marrë nën mbrojtje këtë zonë - Moszbatim i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, sidomos atij për VNM dhe VSM.	- Mungesa e menaxhimit të zonës ka sjellë prishjen e peizazheve, si dhe ka zvogëluar potenciale e rigjenerimit të florës dhe faunës në zonë. - Potenciali turistik i zonës është dobësuar për shkak të mungesave të infrastrukturës në zonat urbane brenda territorit të zonës së mbrojtur.	Komuna e Velipojës, Dajçit, Banorët e Shkodrës qe e shfrytëzojnë për periudhën e verës zonën e plazhit. Fshatrat Pentar, Obot dhe Oblike	është relativisht e lartë. Shfrytëzimi i potencialit natyror të zonës nga ana e komunitetit ka qenë krejtësisht i pastudiuar dhe i egër. Komuniteti nuk është përfshirë direkt në hartimin e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur të mëparshme.	* * *

15. Rënia e sipërfaqeve të pyjeve, e karakterizuar nga: a. zvogëlim i sipërfaqeve të mbjella me pyje b. zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve mjekësore në katin e nënpyllit c. zvogëlim i numrit të shpendëve që folezojnë në pyje d. shoqatat e pyjeve komunale mungojnë.	- Mungesë efektiviteti prej Drejtorisë së Shërbimit Pyjor - Shfrytëzimi i lëndës drusore për djegie - Prerje e pyjeve për sipërfaqe ndërtimi - Niveli i ulët ekonomik në zonë - Niveli i ulët i edukatës mjedisore të njerëzve	- Zvogëlimi i pyjeve çon në rënie të biodiversitetit. - Dëmtimi i pyjeve sjell zvogëlimin e përfitimeve ekonomike. - Zvogëlimi i sipërfaqes së pyjeve ul mundësinë e shfrytëzimit për qëllime turistike - Prishet peizazhi duke u prishur dhe shkatërruar habitatet pyjore, si dhe rritet edhe erozioni në brigje për shkak të prerjeve	Komuna e Velipojës, Dajçit dhe Obotit. Zona e fshatrave të Malit Kolaj dhe Pentarit.	është e mesme. Në zonë ka akoma vlera të mbrojtura, të cilat mund të shtohen dhe të mirëmbahen. Ndërkohë që fuqizimi i ligjit dhe shpallja e zonës së mbrojtur pritet të krijojë kushte të reja ruajtjeje dhe menaxhimi.	* * *
16. Shkallë e lartë e erozioni, e karakterizuar nga: a. zvogëlim i sipërfaqeve të mbjella me pyje në brigjet e Bunës b. shtimi i aktivitetit njerëzor në brigjet e lumenjve c. mospërdorimi i tokës bujqësore d. mungesa e digave mbrojtëse në brigjet e Velipojës afër grykëderdhjes së Bunës e. Prania e pikave për shfrytëzimin e inerteve në Drin, rrit erozionin edhe në brigjet e Bunës	- Dinamika e bregut - Shfrytëzimi i lëndës drusore - Prerje e pyjeve për sipërfaqe ndërtimi - Marrje e rërës dhe e zhavorrit në brigje - Ndërgjegjësim i ulët - Autoritetet lokale jo efikase për të ndikuar në ndërhyrje konkrete në bregdet - Niveli i ulët ekonomik në zonë - Niveli i ulët i edukatës mjedisore të banorëve	- Zvogëlimi i sipërfaqeve të bregut si pasojë direkte. - Humbja e brigjeve detare sjell humbjen e ekosistemeve detare dhe llojeve - Humbja e plazheve me pasoja në humbjen e potencialeve turistike të zonës. - Dëmtimi dhe zvogëlimi i sipërfaqes me pyje. - Prishje e peizazhit dhe shkatërrim i habitateve pyjore.	Komuna e Velipojës, Dajçit dhe Obotit. Zona e fshatrave të Malit Kolaj dhe Pentarit. Komunat e Shirqit dhe e Obotit.	Është e lartë Problemi është i lidhur varg me një sërë ndikimesh të tjera negative në biodiversitet, pyje dhe në humbjen e plazheve.	***

17. Vizion i paqartë për zhvillimin në të ardhmen	- Situata kaotike e krijuar. - Mungesa e koordinimit mes tre sektorëve: qeveri qendrore dhe lokale- OJF të ndryshme -biznes,(faktorët e zhvillimit)	- Degradim i vlerave natyrore - Zhvillim i pakontrolluar dhe kaotik	- E gjithë komuna - Rajoni	E lartë. Pengon investimet serioze.	***
18. Mungesa e banjave publike në zonën e rërës	- Mungesa e projektit teknik dhe e fondeve për zbatimin e tij - Mungesa e kapaciteteve menaxhuese të pushtetit rajonal dhe vendor	- Ndotje e ujit të detit dhe e rërës - Largim i turistëve	Gjithë pushuesit që frekuentojnë detin 40- 50 mijë persona.	E mesme Në rastet e mbushjes së plazhit në kapacitet të lartë dhe në qendër të plazhit ndotja e detit është më e lartë	**
19. Mungesa e vendeve të argëtimit	- Mungesa e planit të zhvillimit	- Largim i turistëve	- Turistët - Popullsia aktive që kërkon sportin dhe aktivitetet e tjera si argëtim	E mesme	**

20. Mungesa e infrastrukturës komunikuese me fshatrat e zonës	- Mungesa e fondeve - Mungesa e një vizioni gjithëpërfshirës nga autoritetet vendore	- Banorët e zonës nuk arrijnë të shfrytëzojnë plazhin si burim të ardhurash dhe e shohin veten larg plazhit megjithëse janë vetëm 4-5 km larg	Banorët e komunës, fermerë, të cilët mund të tregëtojnë produktet e tyre bujqësore dhe blegtorale në plazhin e Velipojës.	E mesme	***
21. Mangësi në njohjen dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve në jetesën në komunitet	- Mangësi metodash të edukimit. - Mangësi në informimin dhe përfshirjen e komunitetit - Paaftësi dhe korrupsion në administrata - Niveli i ulët ekonomik	- I bën njerëzit indiferentë për mjediset e përbashkëta (rruga, mjedisi, pylli, ujërat,etj). - Krijon premisa për hartimin e planeve dhe politikave jo të suksesshme, si rezultat i mospërfshirjes së komunitetit përfitues.	- Gjithë komuniteti dhe të ardhurit e përkohshëm ose ditorë - Turistët - Investitorët - Brezat e ardhshëm	E lartë	***

3. Vlerësimi i mundësive - Rekomandimet

Problemi 1. Ndërtimet pa leje	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Evidentimi i saktë i gjithë ndërtimeve në territorin e komunës; 2. Studimi urbanistik për gjithë fshatrat e komunës; 3. Legalizimi i ndërtimeve sipas ligjit dhe prishja e ndërtimeve të palegalizueshme.	
Mundësia më e parapëlqyer *): **Studimi urbanistik për gjithë fshatrat e komunës.**	I cili respekton: - Vlerat natyrore; - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e tw ardhurave; - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit.

** E cila, respekton më shumë se mundësitë e tjera kushtet e paraqitura në qelizën në të djathtë.*

Problemi 2. Mungesa e studimeve urbanistike pjesore	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Bashkëpunimi me investitorë, pronarët dhe qeverinë lokale e qendrore për parcelizimin e zonave në zbatim të planit të përgjithshëm rregullues 2. Afrimi i donatorëve të fuqishëm për investime	
Mundesia më e parapëlqyer: **Bashkëpunimi me investitorë, pronarwt dhe qeverinë lokale e qendrore për parcelizimin e zonave nw zbatim tw planit tw përgjithshëm rregullues**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit.

Problemi 3. Mungesa e sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Studimi i plotë dhe i saktë i gjendjes aktuale 2. Konsultimi me grupet e interesit 3. Planifikimi i sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza 4. Gjetja e burimeve të nevojshme financiare	
Mundësia më e parapëlqyer: **Studimi dhe planifikimi i sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe realizimi i tyre**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë nëpërmjet nxitjes sw investimeve dhe rritjes së të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit.

Problemi 4. Mungesa e një sistemi të përpunimit të ujërave të zeza	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Studimi dhe planifikimi i ndërtimit të një impianti të përpunimit të ujërave të zeza me sistem ligatinash. 2. Ndërtimi i një sistemi grumbullimi dhe pompimi të ujërave të zeza; 3. Realizimi i një studimi për vendosjen e "teknologjive" më efikase për gropat septike	
Mundësia më e parapëlqyer: **Studimi dhe planifikimi i ndërtimit të një impianti të përpunimit të ujërave të zeza me sistem ligatinash.**	I cili respekton: - Vlerat natyrore dhe mbron ekosistemin. - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit tw komunitetit

Problemi 5. Rritja e madhe e sasisë së mbetjeve urbane	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Rritja e kapaciteteve menaxhuese për këtë problem 2. Studimi dhe planifikimi i veprimeve në përshtatje me zhvillimin 3. Sigurimi i bazës financiare të brendshme ose me donacion	
Mundësia më e parapëlqyer: **Studimi dhe planifikimi i veprimeve në përshtatje me zhvillimin dhe realizimi i projekteve të sakta**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit

Problemi 6. Grumbullim i sasive të mëdha të mbetjeve	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Gjetja e fondeve dhe realizimi i projekteve të mirëfillta të pastrimit 2. Ndërgjegjësimi i komunitetit 3. Bashkëpunimi me donatorët	
Mundësia më e parapëlqyer: **Realizimi i projekteve të mirëstudiuara të pastrimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit.

Problemi 7. Mbetjet urbane grumbullohen në vende të hapura, të papërpunuara dhe pranë qendrave të banuara

Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Përcaktimi i studiuar saktë i pikave të reja të grumbullimit. 2. Përfshirja e Velipojës në fushën rajonale të mbetjeve në Bushat	
Mundësia më e parapëlqyer: **Përfshirja e Velipojës në fushën rajonale të mbetjeve në Bushat**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Ndikon për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirësimin e shëndetit.

Problemi 9. Problemet e pronësisë mbi tokën	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Njohja përfundimtare e pronësisë mbi tokën sipas ligjit 2. Evidentimi dhe zgjidhja e konflikteve, mbivendosjeve, njohja përfundimtare e pronësisë mbi tokën sipas ligjit	
Mundësia më e parapëlqyer: **Njohja përfundimtare e pronësisë mbi tokën sipas ligjit**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 10. Mangësi në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese.	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Krijimi dhe fuqizimi i shoqatave të kullimit dhe vaditjes 2. Pastrimi sistematik i kanaleve të para dhe të dyta nga ndërmarrja e ujërave 3. Ndërhyrje nga fonde të shtetit për pastrim të kanaleve të treta për 10 vjet	
Mundësia më e parapëlqyer: **Krijimi dhe fuqizimi i shoqatave te kullimit dhe vaditjes**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 11. Copëzimi i parcelave të tokave bujqësore në parcela të vogla.
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Përfundimi i ndarjes së tokës bujqësore dhe pajisja me certifikatën e regjistrimit 2. Lehtësimi i procedurave të regjistrimit të pronave 3. Krijimi i kooperativave mbi bazën e pronës private 4. Hapje e tregut të tokës për shitje dhe dhënie me qera

Mundësia më e parapëlqyer: **Përfundimi i ndarjes së tokës bujqësore dhe pajisja me certifikatën e regjistrimit**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 12. Rënia e biodiversitetit në zonë	
Listë e mundësive që mund t'i japin zgjidhje pozitive dhe të qëndrueshme problemit: 1. Hartimi i strategjive lokale për ruajtjen e biodiversitetit në zonë, bazuar në atë kombëtare. 2. Fuqizimi i njësive menaxhuese dhe autoriteteve vendore për ruajtjen e burimeve natyrore, si dhe florës dhe faunës. 3. Nxitja e njerëzve për krijimin e mjediseve të banuara të përafërta me natyrën. 4. Edukimi i njerëzve me dashurinë për natyrën dhe llojet e bimëve dhe kafshëve.	
Mundësia më e parapëlqyer: **Fuqizimi i njësive menaxhuese dhe autoriteteve vendore për ruajtjen e burimeve natyrore, si dhe florës e faunës**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 13. Rënia e sipërfaqeve pyjore	
Listë e mundësive që mund t'i japin zgjidhje pozitive dhe të qëndrueshme problemit 1. Hartimi i planeve të menaxhimit dhe të veprimit për ruajtjen e pyjeve në zonë. 2. Fuqizimi i autoriteteve vendore dhe rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin e tyre 3. Grumbullimi i një koleksioni natyror të zonës me drurë të zonës dhe krijimi i parqeve për vizitore. 4. Edukimi i njerëzve për ruajtjen e pyjeve dhe ndalimin e prerjes pa kriter.	
Mundësia më e parapëlqyer: **Fuqizimi i autoriteteve vendore dhe rajonale për ruajtjen dhe menaxhimin e kësaj pasurie**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 14. Keqmenaxhimi i zonës së mbrojtur
Listë e mundësive që mund t'i japin zgjidhje pozitive dhe të qëndrueshme problemit 1. Zgjerimi i strukturës për zonën e mbrojtur. 2. Ngritja e grupeve të punës me shumë aktorë dhe komunitetin të përfshirë në to, për hartimin e planeve të menaxhimit të zonës së mbrojtur. 3. Nxitja e komunitetit për t'u përfshirw në planet e menaxhimit të zonës.

Mundësia më e parapëlqyer:	I cili respekton:
Ngritja e grupeve të punës me shumë aktorë dhe komunitetin të përfshirë në to, për hartimin e planeve të menaxhimit të zonës së mbrojtur.	- Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 15. Shkallë e lartë e erozionit (detar, tokësor dhe lumor) në zonë	
Listë e mundësive që mund t'i japin zgjidhje pozitive dhe të qëndrueshme problemit 1. Hartimi i një studimi ndërsektorial mbi rrezikun e erozionit, sidomos atij detar. 2. Funksionimi efikas i Drejtorisë së Basenit Ujor për ruajtjen e brigjeve nga erozioni. 3. Edukimi i njerëzve për ruajtjen e pyjeve dhe ndalimin e prerjes pa kriter.	
Mundësia më e parapëlqyer:	I cili respekton:
Hartimi i një studimi serioz dhe ndërsektorial mbi rrezikun që shfaq erozioni, sidomos ai detar.	- Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 16. Mungesa e një zhvillimit të qëndrueshëm si zonë turistike	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Zbatimi i masterplanit të projektit ELPA për zonën turistike, i cili respekton vlerat natyrore, të shoqëruara me zhvillimin e zonës. 2. Rritja e ndërgjegjes së grupeve të interesit për ndërmarrjen e hapave për krijimin e një vizioni të përbashkët, për të respektuar zhvillimin.	
Mundësia më e parapëlqyer:	I cili respekton:
Zbatimi i masterplanit të projektit ELPA për zonën turistike, i cili respekton vlerat natyrore, të shoqëruara me zhvillimin e zonës.	- Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut

Problemi 17. Mungesa e hapësirave çlodhëse dhe të gjelbra për turistët
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Ndërprerje e menjëhershme e ndërtimeve. 2. Zbatimi i masterplaneve që respektojnë këtë kriter dhe i japin frymëmarrje zonës turistike 3. Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese me subjektet private për të nxitur investimet e tyre në këtë drejtim

Mundësia më e parapëlqyer: **Zbatimi i masterplaneve që respektojnë këtë kriter dhe i japin frymëmarrje zonës turistike**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirëson shëndetin e komunitetit.

Problemi 18. Mungesa e vendeve të argëtimit	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Gjetja e hapësirave për këtë qwllim. 2. Zbatimi i masterplaneve që respektojnë këtë kriter 3. Nxitja e nismës private për investime të karakterit argëtues	
Mundësia më e parapëlqyer: **Nxitja e nismës private për investime të karakterit argëtues**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - I shërben ndërgjegjësimit të publikut

Problemi 19. Shkatërrimi i zonës turistike të Rrjollit, një plazh ende i panjohur dhe me shumë vlera	
Lista e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme 1. Zbatimi i masterplanit të projektit ELPA për zonën turistike, i cili respekton vlerat natyrore, të shoqëruara me zhvillimin e zonës. 2. Ndalimi i ndërtimeve me betone. 3. Ndalimi i copëtimit të tokave në troje të vogla ndërtimi	
Mundësia më e parapëlqyer: **Zbatimi i masterplanit të projektit ELPA për zonën turistike, i cili respekton vlerat natyrore, të shoqëruara me zhvillimin e zonës**	I cili respekton: - Vlerat natyrore. - Uljen e varfërisë dhe nxit rritjen e të ardhurave - Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Ndërgjegjësimin e publikut - Përmirëson shëndetin e komunitetit.

4. Plani i Veprimeve

Zhvillimi Urbanistik								
						Lidhja ndërmjet dokumentave*		
Problemi *Listohen problemet me madhore të marrë nga matricat e mësipërme të problemeve*	**Veprimet** *Jep disa nga zgjidhjet konkrete për problemin e marrë në shqyrtim*	**Prioriteti** *Matet me shkallën * Pak i rëndësishëm, ** Mesatar *** Shumë i rëndësishëm*	**Afati kohor** *Matet me shkallën afat i shkurtër deri 5 vjet afat i mesëm deri 10 vjet afat i gjatë deri 15 vjet*	**Aktorët përgjegjës dhe bashkëpuntorë të mundshëm**	**Efekti** *(përshkrim i efektit pozitiv)*	**Plani i Veprimit të PRVM**	**Plani Pilot**	**Strategjia Kombëtare e Mjedisit**
1. Ndërtimet pa leje dhe zhvillimi i pakotrolluar	1.1 Hartimi i planit të përgjithshëm rregullues për komunën 1.2 Përgatitja e planeve pjesore 1.3 Rishikim i planeve të hatuara deri më tani. 1.4 Krijimi i strukturave pranë autoriteteve vendore për ndjekjen, integrimin dhe zbatimin e planeve të pranuara nga të gjithë aktorët	***	Afat shkurtër	1. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit 2. Komuna 3. Banka Botërore	Legalizimi i pronave dhe ndërtimi mbi baza të mirëfillta urbanistike Respektimi i vlerave natyrore dhe krjimi i bazave për zhvillim të qëndrueshëm duke e kthyer Velipojën në një destinacion konkurues në të gjithë bregdetin Adriatik	Tabela për "aktivitetin njerëzor dhe përdorimin e territorit", rreshti nr. 1	Seksionet 5.1, 5.2 dhe 9.1 të dokumentit	Seksionet 2.3.3 dhe 3.3.7 të dokumentit

*) Ky seksion tregon lidhjen ndërmjet dokumentave të përgatitura nga projekti ELPA dhe që shërbejnë si strategji për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në tre nivele, kombëtar, rajonal dhe vendor.

2. Mungesë e studimeve urbanistike pjesore	2.1 Gjetja e fondeve dhe realizimi i tyre 2.2 Rigorozitet në zbatim të tyre duke iu përmbajtur ligjeve në fuqi, sidomos atij të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	***	Afat gjatë	1. Komuna 2. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 3. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit 4. Donatorët	Përmirësim shpejtë i gjendjes aktuale	Tabela për "aktivitetin njerëzor dhe përdorimin e territorit", rreshti nr. 1	Seksionet 2.6, 5.1 dhe 5.2 të dokumentit	Seksionet 2.4.2 dhe 3.3.4 të dokumentit
Kanalizimet e ujrave të zeza								
3. Mungesa e sistemeve të kanalizimeve të ujrave të zeza	3.1. Verifikimi gjendjes së zonave të banimit 3.2. Hartimi i masterplanit të zhvillimit të territorit turistik duke përfshirë sistemet e kanalizimeve 3.3. Hartimi i studimeve urbanistike duke përfshirë trajtimin e ujrave të zeza për zonat e banuara të Komunës. 3.4. Gjetja e burimeve të financimit për studimet për sistemet e kanalizimeve të ujrave të zeza. 3.5. Të përgatiten plane të administrimit dhe funksionimit me realizimin e ndërtimit	***	Afat mesëm	1. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit 3.Komuna 4. Banka Botërore	Zgjidhje përfundimtare e problemeve të ujrave të zeza Krijimi i kushteve për një turizëm bashkëkohor Mbrojtja e vlerave natyrore	Tabela për "aktivitetin njerëzor dhe përdorimin e territorit", rreshti nr. 1	Seksioni 2.6 i dokumentit	Seksionet 2.4.2 dhe 3.3.4 të dokumentit

4. Mungesa e një impjanti të përpunimit të ujrave të zeza	4.1 Hartimi i një studimi fizibiliteti për llojin e sistemit që mund të zbatohet 4.2 Ngritja e një grupi pranë komunës për gjetjen e mundësive financiare për zbatimin e tij	***	Afat mesëm	1. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit 3. Banka Botërore 4. Donatorë të tjerë	Përmbushje e standarteve ndërkombëtare për higjenën në komunitet Zhvillim i një turizmi bashkëkohor	Tabela për "aktivitetin njerëzor dhe përdorimin e territorit", rreshti nr. 1	Seksioni 2.6 i dokumentit	Seksionet 2.4.2 dhe 3.3.4 të dokumentit
5. Rreziku i ndotjes së ujit dhe të rërës si rezultat i mungesës së baterive të banjove publike në plazh.	5.1 Ngritja e pesë baterive me tetë banjo përgjatë bregdetit si dhe baterive të tjera në territore publike	***	Afat shkurtër	1. Komuna 2. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Mbrojtja e bregdetit nga ndotja Përmirësim i kushteve për pushuesit dhe banorët	Tabela për "aktivitetin njerëzor dhe përdorimin e territorit", rreshti nr. 1	Seksioni 2.6 i dokumentit	Seksionet 2.4.2 dhe 3.3.4 të dokumentit

Mbetjet								
6. Rritja e madhe e sasisë së mbetjeve urbane Grumbullim i sasirave të mëdha të mbetjeve Mungesa e fushave sanitare të mbetjeve	6.1. Përgatitja e planeve të veprimit për përballimin e sasive të mbetjeve 6.2 Ngritja e një sistemi që ti përgjigjet nevojës për këtë shërbim 6.3 Bashkëpunim me autoritetet rajonale për përfshirjen në fushën e mbetjeve në Bushat 6.4 Përgatitja e planit të menaxhimit për kostot e këtij shërbimi 6.5 Fuqizimi i rolit të komunës për menaxhimin e mbetjeve 6.6 Rritja e ndërgjegjes komunitare nëpërmjet formave të ndryshme të edukimit dhe përfshirjes së tyre	***	Afat mesëm	1. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit 3. Ministtria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave 4. Komuna	Përmirësim i një shërbimi shumë të nevojshëm për zonën Ritja e tërheqjes turistike të zonës Përmirësim i jetesës në një mjedis të shëndetshëm dhe të kulturuar Edukimi i komunitetit dhe sidomos të brezit të ri për jetën në një komunitet me vlera	Tabela për “aktivitetin njerëzor dhe përdorimin e territorit”, rreshti nr. 3	Seksionet 2.6 dhe 8.2 të dokumentit	Seksionet 2.4.2 dhe 3.3.3 të dokumentit

Larmia boiologjike								
7. Rënia e larmisë biologjike në zonë, e karakterizuar nga: a. pakësimi i sipërfaqeve pyjore b. zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve mjekësore c. zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve dhe kafshëve të rrezikuara d. zvogëlim i numrit të shpendëve që folezojnë në lagunë dhe në pyje e. rënia e burimeve peshkore f. dëmtimi i habitateve si tharja e kënetave dhe preja e kallamishteve g. urbanizimi i zonës gj. mungesa e një plani perspektiv për zhvillimin e rajonit, ku të përfshihet ruajtja e vlerave natyrore dhe e biodiversitetit. h. mungesa e kulturës mjedisore dhe e ndërgjegjësimit të banorëve të rajonit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit. i. mungesa e ndërgjegjësimit të pushuesve për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit.	7.1. Shtimi i sipëfaqeve të pyjeve duke rehabilituar ekzistueset dhe duke mbjellë të reja 7.2 Krijimi i modeleve eksperimentale për kultivimin në mënyrë të qëndrueshme të bimëve mjekësore me leverdi ekonomike 7.3. Ndalimi i gjuetisë së faunës së egër për një periudhë 5 vjecare 7.4. Ndalimi i gjuetisë së shpendëve për një periudhë 5 vjecare 7.5. Rehabilitimi i habitateve të shpendëve 7.6. Ndalimi i gjuetisë së peshkut me mjete të ndaluara si dinamiti dhe energjia elektrike 7.7. Rehabilitimi i mjediseve kënetore 7.8. Zvogëlimi i tendencave të njerëzve për të ndërtuar në zonë 7.9 Reduktimi i përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve në bujqësi 7.10 Ngritja e një vend depozitimi të madh të mbetjeve 7.11. Trainimi i banorëve të komunitetit për ruajtjen e biodiversitetit 7.12. Organizimi i takimeve të vazhdueshme OJF-pushtet vendor dhe komunitet 7.13. Ngritja e një qendre mjedisore	***	7.1 - 5 vjet 7.2 - 5 vjet 7.3 - 5 vjet 7.4 - 5 vjet 7.5 - 5 vjet 7.6 - 5 vjet 7.7 - 5 vjet 7.8 - 5 vjet – 10 vjet 7.9 - Vazhdimisht 7.10 - 5 vjet 7.11 - 2 vjet 7.12 - Vazhdimisht 7.13 - 2 vjet	DSHP Pushteti vendor Komuna Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave OJF-të Administata e zonës së Rezervatit Ndërmarrja e peshkimit Pushteti vendor 1. Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Bashkia e Shkodrës Donatorë që veprojnë në zonë	Rritet sipëfaqja e mbjellë me pyje. Rehabilitohen habitatet dhe përmirësohet imazhi i pejsazheve Rriten të ardhurat e komunitetit dhe shtohet sasia e bimëve mjekësore shtohet flora dhe fauna në zonë Rehabilitohen mjediset jetësore të bimëve dhe kafshëve Kontrollohet lëvizja migratore e njerëzve Zvogëlohet tendenca për të zënë për ndërtim mjediset natyrore Reduktohet ndotja në ekosisitem Reduktohet ndotja në zonën urbane të plazhit të Velipojës Mundësi e mirë menaxhimi për mbetjet në zonë Ndërgjegjësohen banorët dhe plazhistët për rëndësinë e ruajtjes së mjediseve, florës dhe faunës Krijohen mundësi për marrje të informacionit mjedisor dhe të edukatës mjedisore Rritet shkalla e argëtimit dhe e kënaqësisë së njerëzve	Tabela për "Biodiver-siteti dhe zonat e mbrojtura", rreshti nr. 1	Seksionet 6.1 dhe 7.1 të dokumentit	Seksionet 2.4.6 dhe 3.3.6 të dokumentit

Zonat e mbrojtura								
8. Keq menaxhimi i zonave të mbrojtura, e karakterizuar nga: a. zvogëlim i sipërfaqeve të habitateve pyjore dhe dëmtimi i habitateve ujore brenda territorit të zonës së mbrojtur b. struktura administrative menaxhimin e zonës së mbrojtur është e pamjaftueshme dhe me mungesa në logjistikë c. zvogëlim i numrit të llojeve bimore dhe shtazore sidomos lagunë dhe në pyje d. vlerat ekoturistike të rajonit janë cënuar rëndë nga dëmtimet pa leje e. mungesa e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur	8.1 Rehabilitimi i brezave pyjore brenda territorit të zonës së mbrojtur 8.2 Përmirësimi i ekosistemeve ujore në Bunë, grykëderdhjen e saj, në Lagunën e Vilunit dhe kënetat rreth saj 8.3 Krijimi i habitateve artificiale në ngjashmëri me ato natyrore brenda territorit të zonës së mbrojtur 8.4 Fuqizimi i strukturave menaxhuese 8.5 Trainimi i specialistëve 8.6 Ngritja e një qendre mjedisore 8.7 Hartimi i planeve të veprimit 8.8 Trainimi i komunitetit dhe i nxënësve të shkollave për ruajtjen e biodiversitwetit; 8.9 Ndalimi i gjuetisë brenda territorit të zonës së mbrojtur 8.10 Prishja e ndërtimeve pa leje; 8.11 Ndalimi i lejeve për ndërtim 8.12 Hartimi i planit të menaxhimit për zonën e mbrojtur 8.13 Përdorimi i produkteve miqësore me mjedisin në bujqesi.	***	8.1 - 5 vjet 8.2 - 5 vjet 8.3 - 5 vjet 8.4 - 5 vjet 8.5 - Vazhdimisht 8.6 - 5 vjet 8.7 - 5 vjet 8.8 - Vazhdimisht 8.9 - 5 vjet 8.10 - Menjëherë 8.11 - Vazhdimisht 8.12 - Menjëherë 8.13 Vazhdimisht	Pushteti vendor Komuna Drejtoria e Shërbimit Pyjor OJF-të Komuniteti	Rritja e sip të pyjeve brenda zonës së mbrojtur Rritja e potencialit ekologjik në zonë dhe ndikimi në rrritjen e vlerave të biodiversitetit Përmirësimi i habitateve kyce Përmirësimi i gjendjes së llojeve Forcimi i kapaciteteve menaxhuese në zonë Ngritja e kapaciteteve të specialistëve në zonë Forcimi i edukatës mjedisore të njerëzve Përmirësimi i habitateve dhe llojeve kyce Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhim Përmirësimi dhe ruajtja e ekosistemeve brenda territorit të zonës së mbrojtur Forcimi i vlerave dhe zbatimi i normave të konventave dhe ligjeve mjedisore Kontrolli i ndikimit të urbanizimit në zonën e mbrojtur Përmirësimi i cilësisë së shërbimit për komunitetin Vënia në jetë e planit të menaxhimit të mbetjeve	Tabela për "Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura", rreshti nr. 1	Seksionet 6.1 dhe 7.1 të dokumentit	Seksionet 2.4.6 dhe 3.3.6 të dokumentit

Pyjet								
9. Zvogëlimi sipëfaqeve të pyjeve. e karakterizuar nga: a. zvogëlim i sipërfaqeve të mbjella me pyje b. zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve mjekësore në katin e nënpyllit c. zvogëlim i numrit të shpendëve që folezojnë në pyje d. shoqatat e pyjeve komunale mungojnë e. Kapacitete të kufizuara në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor	9.1. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore ekzistuese 9.2. Rehabilitim i brezave pyjorë përgjatë lumit Buna 9.3. Mbjella e pishave të reja në brezin e pishave nga qendra grykëderdhja e Bunës deri në Vilun 9.4. Krijimi i arealeve eksperimentale për kultivimin e bimëve mjekësore 9.5. Rehabilitim i foleve të zogjve në pyllin me pisha 9.6. Ruajtja e foleve gjatë periudhës së folezimit të shpendëve 9.7. Krijimi i shoqatave të pyjeve komunalë 9.8. Dhënia e sipërfeqeve të pyjeve në përdorim shoqatave të pyjeve komunlë ose anëtarëve të komunitetit 9.9. Zbatimi i ligjit dhe vënia e gjobave për persona dhe ente që dëmtojne pyjet 9.10. Trainimi i punonjësve të shërbimit pyjor	**	9.1 - 5 vjet 9.2 - 5 vjet 9.3 - 5 vjet 9.4 - 5 vjet 9.5 - Vazhdimsht 9.6 - Vazhdimisht 9.7 - 5 vjet 9.8 - 5 vjet 9.9 - Vazhdimisht 9.10 - Vazhdimisht	Pushteti vendor Prefektura Komuna Drejtoria e Shërbimit Pyjor Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave OJF-të Donatorë Komuniteti	Shtimi i sipërfaqeve pyjore Zvogëlimi i erozionit rehabilitimi i habitateve Shtim i bimëve mjekësore dhe mundësi e mirë për menaxhimin e tyre Shtim i faunës së egër sidomos i ornitofaunës Ruajtje e biodiversitetit Rritje e kapaciteteve të komunitetit për menaxhimin e burimeve natyrore sidomos atyre pyjore Mundësi e mirë e menaxhimit të pyjeve Forcimi i legjislacionit Rritje e kapcitetiteve profesionale të specialistëve dhe forcim i edukatës mjedisore tek ata	Tabela për "Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura", rreshti nr. 3	Seksionet 6.1 dhe 7.1 të dokumentit	Seksionet 2.3.2, 2.4.6 dhe 3.3.6 të dokumentit

Erozioni								
10. Shkalla e lartë e erozionit, e karakterizuar nga: a. zvogëlim i sipërfaqeve të mbjella me pyje në brigjet e Bunës b. shtimi i aktivitetit njerëzor në brigjet e lumenjve c. mospërdorimi i tokës bujqësore d. mungesa e digave mbrojtëse në brigjet e Velipojës afër grykëderdhjes së Bunës e. shfrytëzimi i inerte në Drin rrit ndikimin e erozionit edhe në brigjet e Bunës	10.1. Mbjellja e pyjeve në brigjet e Bunës 10.2. Ndërtimi i brezave pritës (diga apo breza betoni) 10.3. Mbjellja e tokave përgjatë brigjeve 10.4. Ndërtimi i brezave (digave) mbrojtëse në brendësi të detit në zonën e grykëderdhjes ku erozioni është më i madh 10.5 Ndalimi i subjekteve të palicesuara që marrin zhavorret në brigjet e lumenjve	***	10.1 - 5 vjet 10.2 - 5 vjet 10.3 - 5 vjet 10.4 - 10 vjet 10.5 - 5 vjet	Pushteti vendor Komuna Drejtoria e Shërbimit Pyjor OJF-të Komuniteti Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Ministria e Ndërtimit dhe Rregullimit të Territorit	Minimizimi i efektit të erozionit në bregun e Bunës Rehabilitimi i bregut të Bunës Përdorimi me efikasitet i tokës në bujqësi Minimizimi i efektit të erozionit bregdetar Ruajtja e brigjeve dhe e pasurive inerte	Tabela për "Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura", rreshti nr. 4	Seksioni 2.3 i dokumentit	Seksionet 2.4.3 dhe 3.3.5 të dokumentit

Zhvillimi i turizmit, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit								
11.Mungesa e studimit urbanistik të zhvillimit të qëndrueshëm si zonë turistike	11.1. Zbatimi i planeve të zhvillimit të integruar dhe respektojnë kushtet mjedisore dhe turistike dhe i japin mundësi komunës të zhvillohet me mundësitë e shumta të zonës 11.2 Zbatimi i parimeve masterplanit të projektit ELPA për zonën e bregdetit	***	Afat shkurtër	1. Komuna 2. Ministritë e linjës	Do të krijohen premisa për një zonë me turizëm të qëndrueshëm. Vetëm në këtë mënyrë komuna mund të bëjë hapa përpara dhe në mënyrën e duhur për zhvillim.	Tabela për "Turizmin" rreshti nr. 1	Seksionet 2.4 dhe 4 të dokumentit	Seksionet 2.3.3 dhe 3.3.7 të dokumentit
12. Mungesa e banjave publike në zonën e rerës	12.1. Të përcaktohen vendet e nevojshme funksionale për këtë qëllim. 12.2. Të hartohen projektet e zbatimit të cilët do të përcaktojnë dhe kostot 12.3. Fuqizimi i rolit të komunës për mirëmbajtjen e tyre 12.4. Zhvillimi sa më shpejt i nismës për një sistem të largimit dhe përpunimit të ujrave të zeza për komunën.	**	Afat mesëm	1. Komuna 2. Donatorë	Krijon kushte higjenike për pushuesit dhe rrit shkallën e kulturës turistike të zonës Edukon banorët për një kulturë të jetuari në komunitete të shëndosha	Tabela për "Turizmin" rreshti nr. 1	Seksionet 2.4 dhe 4 të dokumentit	Seksionet 2.3.3 dhe 3.3.7 të dokumentit

13. Mungesa e vendeve të argëtimit	13.l. Të projektohet krijimi i një kompleksi sportiv, fushe futbolli etj., në harmoni me planin e zhvillimit të komunës 13.2. Të krijohen mjedise të ndryshme argëtimi	*	Afat gjatë	1. Komuna. 2. Bizneset 3. OJF	Velipoja do të ketë jo vetëm plazhin, det dhe rërë por dhe mjedise ku të pushosh dhe argëtohesh	Tabela për "Turizmin" rreshti nr. 1	Seksioni 4 i dokumentit	
14. Njerëzit kanë mangësi në njohjen dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve ndaj njëri-tjetrit në jetesën në komunitet .	14.1. Të punohet që njerzit të mësohen të mendojnë se në demokraci vepron ligji. 14.2. Të punohet që njerëzit të zbatojnë rregullat e jetesës në komunitet. 14.3. Të punohet që njerëzit të mos jenë indiferentë ndaj shkelësve të rregullave. 14.4. Të ngrihen qendra të informimit të publikut.	**	Afat mesëm	1. Komuna 2. OJF 3. Donatorë të ndryshëm	Rrit shkallën e angazhimit të komunitetit dhe për rrejdhojë krijon kushte të reja zhvillimi në harmoni me natyrën dhe të ardhmen turistike të zonës Përgatit një brez të ri më të përgjegjshëm	Tabela për "Turizmin" rreshti nr. 2	Seksioni 6.2 i dokumentit	Seksionet 4.6 dhe 5.11 të dokumentit

5. Monitorimi dhe Vlerësimi

Problemi	Ndryshimi i pritur	Indikatorët për matje	Vlerësimi
1. Ndërtimet pa leje dhe zhvillimi i pakontrolluar	Legalizimi i pronave dhe ndërtimi mbi baza të mirëfillta urbanistike Respektimi i vlerave natyrore dhe krijimi i bazave për zhvillim të qëndrueshëm duke e kthyer Velipojën në një destinacion konkurrues në të gjithë bregdetin Adriatik	1. Numri i kërkesave për regjistrim pranë agjencisë qeveritare për legalizimin (ALUIZNI), 2. Numri i ndërtimeve të paligjshme në zonë; 3. Kërkesa për ndërtime të reja krahasuar me tokën për ndërtim.	1. 100 % e ndërtesave të njohura të regjistruara deri në pjesën e parë të vitit 2007; 2. Duke filluar nga 2007, të gjitha nevojat dhe kërkesat për ndërtim të dërguara në komunë;
2. Mungesë e studimeve urbanistike pjesore	Përmirësim shpejtë i gjendjes aktuale	4. Miratimi i planit të përgjithshëm rregullues për komunën; 5. Numri i kërkesave pranë autoriteteve vendore për studime pjesore.	3. Plani i përgjithshëm rregullues i pranuar nga të gjithë aktorët dhe i miratuar nga autoritetet vendore; 4. Fillimi i hartimit të planeve pjesore në zonën e plazhit gjatë 2007.
3. Mungesa e sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza	Zgjidhje përfundimtare e problemeve të ujërave të zeza Krijimi i kushteve për një turizëm bashkëkohor Mbrojtja e vlerave natyrore	6. Përqindja e grantit komunal e caktuar për shërbimet publike; 7. Sasia e metrave lineare kanalizime ujërash të zeza ndërtuar në vit.	5. Për t'u diskutuar lidhur me fondet vjetore që përcaktohen nga qeverisja qendrore.
4. Mungesa e një impianti të përpunimit të ujërave të zeza	Përmbushje e standardeve ndërkombëtare për higjienën në komunitet Zhvillim i një turizmi bashkëkohor	8. Numri i njësive për trajtimin e ujërave të zeza për numër banorësh; 9. Numri i familjeve të lidhura me sistemin e trajtimit të ujërave të zeza; 10. Numri i gropave septike të mbyllura në zonë.	6. Të paktën një sistem për trajtimin e ujërave të zeza i ndërtuar brenda 2008; 7. Të paktën 30% e familjeve të komunës të lidhura me sistemin; 8. Të paktën 20 % e gropave septike të mbyllura.
5. Rreziku i ndotjes së ujit dhe të rërës si rezultat i mungesës së baterive të banjove publike në plazh.	Mbrojtja e bregdetit nga ndotja Përmirësim i kushteve për pushuesit dhe banorët	11. Numri i banjove publike të vendosura në zonën e plazhit; 12. Numri i shtëpive dhe ndërtesave për përdorim turistik të lidhura me sistemin e pastrimit të ujërave të zeza; 13. Sasia/përqindja e ndotjes së ujërave, rërës dhe tokës.	9. Të paktën 5 banjo funksionale brenda 2007; 10. 100 % e ndërtesave të plazhit të lidhura me sistemin e trajtimit të ujërave të zeza deri në fund të 2008; 11. Të paktën 50% rënie ndotjes.

6. Rritja e madhe e sasisë së mbetjeve urbane Grumbullim i sasive të mëdha të mbetjeve Mungesa e fushave sanitare të mbetjeve	Përmirësim i një shërbimi shumë të nevojshëm për zonën Rritja e tërheqjes turistike të zonës Përmirësim i jetesës në një mjedis të shëndetshëm dhe të kulturuar Edukimi i komunitetit dhe sidomos të brezit të ri për jetën në një komunitet me vlera	14. Numri i fushave sanitare të mbetjeve në zonë; 15. Sasia e mbetjeve të prodhuara nga banorët dhe turistët në vit, të cilat depozitohen në fushën e mbetjeve; 16. Përfshirja në projektin teknik të fushës rajonale në Bushat i komunës Velipojë.	12. Mbyllja e fushës ekzistuese të mbetjeve deri në fund të 2008; 13. E gjithë sasia e mbetjeve të prodhuara, mblidhet dhe depozitohet; 14. Velipoja e përfshirë në skemën e projektit rajonal të mbetjeve në 2007.
7. Rënia e larmisë biologjike në zonë, e karakterizuar nga: a. Pakësimi i sipërfaqeve pyjore b. Zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve mjekësore c. Zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve dhe kafshëve të rrezikuara d. Zvogëlim i numrit të shpendëve që folezojnë në lagunë dhe në pyje e. Rënia e burimeve peshkore f. Dëmtimi i habitateve si tharja e kënetave dhe preja e kallamishteve g. Urbanizimi i zonës gj. Mungesa e një plani perspektiv për zhvillimin e rajonit, ku të përfshihet ruajtja e vlerave natyrore dhe e biodiversitetit. h. Mungesa e kulturës mjedisore dhe e ndërgjegjësimit të banorëve të rajonit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit. i. Mungesa e ndërgjegjësimit të pushuesve për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit.	Rritet sipërfaqja e mbjellë me pyje. Rehabilitohen habitatet dhe përmirësohet imazhi i peisazheve Rriten të ardhurat e komunitetit dhe shtohet sasia e bimëve mjekësore Shtohet flora dhe fauna në zonë Rehabilitohen mjediset jetësore të bimëve dhe kafshëve Kontrollohet lëvizja migratore e njerëzve Zvogëlohet tendenca për të zënë për ndërtim mjediset natyrore Reduktohet ndotja në ekosisitem Reduktohet ndotja në zonën urbane të plazhit të Velipojës Mundësi e mirë menaxhimi për mbetjet në zonë Ndërgjegjësohen banorët dhe plazhistët për rëndësinë e ruajtjes së mjediseve, florës dhe faunës Krijohen mundësi për marrje të informacionit mjedisor dhe të edukatës mjedisore Rritet shkalla e argëtimit dhe e kënaqësisë së njerëzve	17. Numri i llojeve migratore që vizitojnë zonën; 18. Numri i turistëve dhe vizitorëve të interesuar për vlerat natyrore të zonës; 19. Rritje e cilësisë së ujërave dhe tokës, veçanërisht në zonat e mbrojtura.	15. Të paktën të gjitha llojet e vëzhguara si vizitorë të rregullt të mëparshëm në zonë, të kthyer brenda 2008; 16. Të paktën studentët dhe nxënësit e shkollave nga zona të ndryshme të vendit, të vizitojnë zonën çdo vit; 17. Jo më derdhje e ujërave të zeza në zonën e mbrojtur, duke filluar që nga 2008.

8. Keqmenaxhimi i zonave të mbrojtura, e karakterizuar nga: a. Zvogëlim i sipërfaqeve të habitateve pyjore dhe dëmtimi i habitateve ujore brenda territorit të zonës së mbrojtur b. Struktura administrative menaxhimin e zonës së mbrojtur është e pamjaftueshme dhe me mungesa në logjistikë c. Zvogëlim i numrit të llojeve bimore dhe shtazore sidomos lagunë dhe në pyje d. Vlerat ekoturistike të rajonit janë cenuar rëndë nga dëmtimet pa leje e. mungesa e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur	Rritja e sipërfaqes të pyjeve brenda zonës së mbrojtur Rritja e potencialit ekologjik në zonë dhe ndikimi në rritjen e vlerave të biodiversitetit Përmirësimi i habitateve kyçe Përmirësimi i gjendjes së llojeve Forcimi i kapaciteteve menaxhuese në zonë Ngritja e kapaciteteve të specialistëve në zonë Forcimi i edukatës mjedisore të njerëzve Përmirësimi i habitateve dhe llojeve kyçe Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhim Përmirësimi dhe ruajtja e ekosistemeve brenda territorit të zonës së mbrojtur Forcimi i vlerave dhe zbatimi i normave të konventave dhe ligjeve mjedisore Kontrolli i ndikimit të urbanizimit në zonën e mbrojtur Përmirësimi i cilësisë së shërbimit për komunitetin Vënia në jetë e planit të menaxhimit të mbetjeve	20. Sasia e fondeve të akorduara nga qeverisja qendrore për zonat e mbrojtura; 21. Fuqizimi i ARM Shkodër (më mirë e pajisur dhe me më shumë staf); 22. Përgatitja e planit të menaxhimit për të gjithë zonën e mbrojtur; 23. Miratimi i planit të përgjithshëm rregullues për komunën.	18. Rritje e fondeve për zonat e mbrojtura (sasia e diskutueshme në varësi të buxhetit total dhe lëvizjeve administrative); 19. Plani për menaxhimin e zonave të mbrojtura i përgatitur dhe miratuar brenda 2008; 20. Plani i përgjithshëm rregullues i përgatitur dhe miratuar brenda 2008.
9. Zvogëlimi sipëfaqeve të pyjeve. e karakterizuar nga: a. Zvogëlim i sipërfaqeve të mbjella me pyje b. Zvogëlim i numrit të llojeve të bimëve mjekësore në katin e nënpyllit c. Zvogëlim i numrit të shpendëve që folezojnë në pyje d. Shoqatat e pyjeve komunale mungojnë e. Kapacitete të kufizuara në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor	Shtimi i sipërfaqeve pyjore Zvogëlimi i erozionit rehabilitimi i habitateve Shtim i bimëve mjekësore dhe mundësi e mirë për menaxhimin e tyre Shtim i faunës së egër sidomos i ornitofaunës Ruajtje e biodiversitetit Rritje e kapaciteteve të komunitetit për menaxhimin e burimeve natyrore sidomos atyre pyjore Mundësi e mirë e menaxhimit të pyjeve Forcimi i legjislacionit Rritje e kapcitetiteve profesionale të specialistëve dhe forcim i edukatës mjedisore tek ata	24. Numri i pemëve të mbjella në vit; 25. Rritje e popullatave të florës dhe faunës; 26. Numri i gjobave të vendosura për çështje të dëmtimit të mjedisit për vit; 27. Sasia e erozionit në vit (mundësisht rënie e tij ose ndalim).	21. DSHP të ketë përgatitur një plan veprimi për mbjelljen e pemëve duke nisur nga 2007 dhe zbatimin e tij duke nisur që nga 2008; 22. Përmirësim i gjendjes së popullatave të florës dhe faunës, të vëzhguara nga MMPAU; 23. Ndalimi i erozionit në disa pjesë të bregdetit dhe përgjatë brigjeve të lumit Buna deri në 2009.

10. Shkalla e lartë e erozionit, e karakterizuar nga: a. Zvogëlim i sipërfaqeve të mbjella me pyje në brigjet e Bunës b. Shtimi i aktivitetit njerëzor në brigjet e lumenjve c. Mospërdorimi i tokës bujqësore d. Mungesa e digave mbrojtëse në brigjet e Velipojës afër grykëderdhjes së Bunës e. Shfrytëzimi i inerteve në Drin rrit ndikimin e erozionit edhe në brigjet e Bunës	Minimizimi i efektit të erozionit në bregun e Bunës Rehabilitimi i bregut të Bunës Përdorimi me efikasitet i tokës në bujqësi Minimizimi i efektit të erozionit bregdetar Ruajtja e brigjeve dhe e pasurive inerte	28. Sasia e erozionit detar, lumor dhe tokësor për vit (mundësisht rënie e tij ose ndalim); 29. Numri i pemëve të mbjella përgjatë brigjeve të lumenjve dhe zonës bregdetare; 30. Niveli i kripshmërisë së tokës dhe pellgjeve ujore në zonë.	24. Ndalimi i erozionit në disa zona të bregdetit dhe mundësisht fillimi i avancimit të rërës deri në 2008. 25. Të paktën zonat e mbrojtura të fillojnë rigjenerimin deri në 2009.
11.Mungesa e studimit urbanistik të zhvillimit të qëndrueshëm si zonë turistike	Do të krijohen premisa për një zonë me turizëm të qëndrueshëm. Vetëm në këtë mënyrë komuna mund të bëjë hapa përpara dhe në mënyrën e duhur për zhvillim.	31. Miratimi i SKM nga qeverisja qendrore dhe fillimi i zbatimit të rekomandimeve të PRVM, PLVM dhe Planit Pilot për zonën bregdetare; 32. Numri i rekomandimeve të zbatuara për vit; 33. Numri i vizitorëve dhe turistëve që vizitojnë zonën krahasuar me vitin e shkuar; 34. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës turistike; 35. Rritje e popullatave të florës dhe faunës.	26. Miratimi nga qeveria shqiptare i planeve të përgatitura nga projekti ELPA gjatë 2007dhe fillimi i zbatimit të rekomandimeve të tyre nisur nga 2008; 27. Sistemi i trajtimit të ujërave të zeza i ndërtuar për zonën e plazhit jo më vonë se 2008. 28. Numri i vizitorëve i rritur të paktën 10% gjatë 2007.
12. Njerëzit kanë mangësi në njohjen dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve ndaj njëri-tjetrit në jetesën në komunitet .	Rrit shkallën e angazhimit të komunitetit dhe për rrjedhojë krijon kushte të reja zhvillimi në harmoni me natyrën dhe të ardhmen turistike të zonës Përgatit një brez të ri më të përgjegjshëm	36. Numri i aktiviteteve mjedisore të ndërmarra nga OJF-të vendore; 37. Numri i orëve për edukimin mjedisor të dhëna në shkollë; 38. Numri i qendrave të informacionit të ngritura në zonë.	29. Ngritja të paktën e një qendre informacioni për vizitorët brenda 2007; 30. Ngritja e grupeve ekologjike në shkollat e komunës brenda 2007; 31. Të paktën një libër apo metodologji për edukimin mjedisor e përfshirë në kurrikulën e shkollës.

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS

Komuna Velipojë

për një komunitet të shëndetshëm
në mjedis të shëndetshëm